



# DESTINACIONI NË NATO:

## Alternativat e Kosovës drejt anëtarësimit në NATO

Maj, 2015



# **DESTINACIONI NË NATO:**

## **Alternativat e Kosovës drejt anëtarësimit në NATO**

Maj, 2015

**Botues:**

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

**Autor:**

Plator Avdiu

**Redaktimi i brendshëm:**

Florian Qehaja

Mentor Vrajolli

**Redaktimi i jashtëm:**

Shpend Kursani

**Lekturimi në shqip:**

Shemsi Haziri

Maj, 2015

Shënim: Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze.

---

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat për pronësi intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes, ose të transmetohet në ndonjë formë apo me ndonjë mjet elektronik, mekanik ose ndryshe, pa lejen paraprake të botuesit.

Ky projekt është mbështetur nga Think Tank Fund – Fondacioni për Shoqëri të Hapur. Pikëpamjet shprehura në këtë studim janë të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë ato të Think Tank Fund – Fondacionit për Shoqëri të Hapur.

---

# TABELA E PËRMBAJTJES

---

LISTA E SHKURTESAVE .....6

TABELA E FIGURAVE.....7

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....8

HYRJE..... 11

METODOLOGJIA ..... 12

SEKSIONI 1 – ROLI I NATO-S NË KOSOVË GJATË PERIUDHËS SË PASLUFTËS (1999-2008)..... 13

SEKSIONI 2 – MARRËDHËNIET E KOSOVËS ME NATO-N (2008-2015)..... 16

    2.1.Katër vendet mos-njohëse..... 16

    2.2.Marrëdhëniet aktuale ndërmjet Kosovës dhe NATO-s ..... 18

    2.3.Forcat e Armatosura të Kosovës kundrejt NATO-s ..... 24

    2.4.Perceptimi publik në Kosovë për integrim në NATO dhe krahasimi me vendet e rajonit..... 25

SEKSIONI 3 – POLITIKAT ALTERNATIVE PËR MARRËDHËNIET E ARDHSHME KOSOVË-NATO..... 29

    3.1. Skenari i parë: Nga dialogu Kosovë-NATO deri te anëtarësimi me të drejta të plota..... 29

    3.2.Skenari i dytë: Bashkëpunimi dypalësh me vendet e NATO-s..... 33

REKOMANDIME..... 35

LISTA E ANEKSEVE..... 38

BIBLIOGRAFIA ..... 40

INTERVISTAT .....45

---

# LISTA E SHKURTESAVE

---

AC	Karta e Adriatikut
AP NATO	Asambleja Parlamentare e NATO-s
BE	Bashkimi Evropian
BH	Bosnja dhe Hercegovina
BKS	Barometri Kosovar i Sigurisë
COMKFOR	Komandanti i KFOR-it
DNPS	Departamenti për NATO dhe Politika të Sigurisë
EKN	Ekipi Këshillëdhënës i NATO-s
ENKN	Ekipi Ndërlidhës dhe Këshillëdhënës i NATO-s
FAK	Forcat e Armatosura të Kosovës
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GPN	Grupi Punues për NATO-n
KFOR	Forca e Kosovës
KSK	Këshilli i Sigurisë së Kosovës
KPO	Kapacitetet e Plota Operacionale
KSOKB	Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
KVA	Këshilli Veri-Atlantik
MFSK	Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
MM	Ministria e Mbrojtjes
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PpP	Partneriteti për Paqe
PSNK	Përfaqësuesi Special i NATO-s në Kosovë
PVA	Plani i Veprimit për Anëtarësim
PVPI	Plani i Veprimit për Partneritet Individual
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
RACVIAC	Qendra për Asistim në Zbatim dhe Verifikim të Kontrollit Rajonal të Armëve
RFJ	Republika Federative e Jugosllavisë
RSSS	Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë
SOFA	Marrëveshja për Statusin e Forcave
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
VMN	Vendet Mos-Njohëse
ZKMK	Zyra e Kryeministrit të Kosovës
ZNNK	Zyra Ndërlidhëse e NATO-s në Kosovë

---

# TABELA E FIGURAVE

---

FIGURAT

Figura 1: Perceptimi publik në Kosovë për anëtarësim në NATO ..... 26

Figura 2: Perceptimi publik në Kosovë në krahasim me Malin e Zi, Maqedoninë dhe Bosnjën dhe  
Hercegovinën për anëtarësim në NATO..... 27

Figura 3: Skenari i parë – Nga dialogu Kosovë-NATO deri te anëtarësimi me të drejta të plota ..... 32

Figura 4: Skenari i dytë – Bashkëpunimi dypalësh me vendet e NATO-s..... 34

TABELAT

Tabela 1 – Korniza institucionale e Kosovës kundrejt integritimit në NATO..... 38

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### KONTEKSTI:

- Marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe NATO-s filluan gjatë intervenimit humanitar të NATO-s në Kosovë dhe fushatës së saj ajrore 78-ditëshe kundër Serbisë. Këto marrëdhënie u zhvilluan më tej me vendosjen e misionit paqeruajtës ushtarak të NATO-s në Kosovë (KFOR-it) pas përfundimit të luftës në vitin 1999. Që nga ajo kohë, KFOR-it i ishte dhënë roli kryesor në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes në Kosovë. Si pasojë e përmirësimit të situatës së sigurisë në Kosovë, NATO-ja ka zvogëluar trupat e saj në Kosovë nga 50,000 ushtarë në vitin 1999 në më pak se 5,000 ushtarë në vitin 2015 dhe gradualisht ka bërë bartjen e disa prej përgjegjësisë të saj tek institucionet e Kosovës.

### SFIDAT:

- Shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 nuk solli asnjë ndryshim në marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe NATO-s. Pas pavarësisë, NATO-ja miratoi qëndrimin e saj neutral kundër Kosovës dhe vazhdoi të funksionojë në Kosovë sipas Rezolutës 1244. Kjo për shkakun se katër vende anëtare të NATO-s - Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja - nuk e njohën Kosovën.
- Sa i përket bashkëpunimit me NATO-n, Kosova është e bllokuar në të gjitha aspektet duke mos e gëzuar të drejtën e pjesëmarrjes në mekanizmat bashkëpunues dhe programet e ndryshme të NATO-s. Kosova nuk ka vendosur asnjë marrëdhënie dypalëshe zyrtare me NATO-n, duke u bërë vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor që nuk ka ndonjë formë të bashkëpunimit me Këshillin Veri-Atlantik të NATO-s. Arsyet për këtë janë të analizuara gjerësisht në raport.
- Sipas disa dokumenteve zyrtare të NATO-s, anëtarësimi i Kosovës në programin e Partneritetit për Paqe mund të kushtëzohet paraprakisht prej anëtarësimit në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Meqë Kosova nuk është anëtare e kësaj organizate, kjo mund të shkaktojë një tjetër pengesë për Kosovë që të bëhet pjesë e Partneritetit për Paqe.
- Përpjekjet e politikëbërësve në Kosovës për fuqizimin e marrëdhënieve me NATO-n kanë qenë të kufizuara vetëm në aspektin deklarativ. Institucionet e Kosovës nuk kanë bërë ndonjë kërkesë zyrtare në NATO për vendosjen e marrëdhënieve zyrtare me Kosovën.
- Kuvendi i Kosovës nuk e ka miratuar ende pakon kushtetuese dhe legjislativë që do të shndërronte Forcën e Sigurisë së Kosovës në Forcë të Armatosura të Kosovës. Kjo varet nga miratimi i dy të tretave të shumicës së dyfishtë të Kuvendit - që nënkupton se dy e treta e pakicave duhet të japin pëlqimin për këtë. Nuk ka ndonjë afat kohor se kur do të miratohen në Kuvend këto ndryshime.
- Përkundër këtyre sfidave, vendet mike të Kosovës në NATO kanë këmbëngulur që Kosova duhet të lëviz përpara drejt anëtarësimit në Partneritetin për Paqe dhe në NATO.



*Skenari i parë:*

- Institucionet e Kosovës duhet të kërkojnë në mënyrë të qartë nga Këshilli Veri-Atlantik i NATO-s hapjen e dialogut të strukturuar dhe zyrtar me Kosovën. Ky dialog duhet të jetë i kufizuar saktësisht sipas afateve kohore, pra nuk duhet të zgjas më shumë se dy vite dhe qëllim kryesor duhet të ketë përgatitjen e Kosovë që të marrë pjesë e të fitojë anëtarësimin në Partneritetin për Paqe dhe në NATO.
- Dialogu i mundshëm ndërmjet Kosovës dhe NATO-s duhet të përqendrohet në vlerësimin gjithëpërfshirës të kontributit të KFOR-it në Kosovë dhe të rishikojë të gjitha detyrat e mbetura të këtij misioni para se të bëhet tërheqja graduale e trupave të KFOR-it. Dialogu Kosovë-NATO duhet të sigurojë që institucionet e Kosovës në fushën e sigurisë, në veçanti Policia e Kosovës dhe Forcat e Armatosura të Kosovës do të forcohen në mënyrë adekuate dhe të jenë të afta për të marrë përgjegjësitë e plota nga KFOR-i në ofrimin e sigurisë në tërë territorin e Kosovës.
- Dialogu i mundshëm ndërmjet Kosovës dhe NATO-s duhet të parashikojë bartjen graduale të përgjegjësisë kryesore të KFOR-it tek Forcat e Armatosura të Kosovës. Duke e ditur që mandati i KFOR-it buron nga Rezoluta 1244 e cila ende nuk është shfuqizuar nga Këshilli i Sigurimit, atëherë me zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe operative të Forcave të Armatosura të Kosovës, kjo në mënyrë të tërthortë do ta bënte rolin e KFOR-it në Kosovë të panevojshëm para shteteve anëtare të NATO-s. Si pasojë e kësaj, rëndësia e Forcave të Armatosura të Kosovës do të rritej dhe kjo do të çonte deri tek marrja e përgjegjësisë nga KFOR-i për të garantuar një ambient të qetë dhe të sigurt në vend.
- Dialogu Kosovë-NATO duhet të zgjidh këto çështje: të bëhet demarkacioni kufitar në mes të Kosovës dhe Serbisë, qoftë nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, qoftë të NATO-s; të themelohet Zyra Ndërlidhëse e NATO-s në Kosovë; të emërohet Përfaqësuesi Special i NATO-s në Kosovë; dhe të themelohet Grupi Punues për NATO-n në kuadër të Qeverisë së Kosovës.
- Synimi final i këtij dialogu Kosovë-NATO duhet të jetë nënshkrimi i një marrëveshjeje prej të dyja palëve që do ta shpinte Kosovën përfundimisht drejt hyrjes në dialog kontraktual me NATO-n dhe do të mundësonte pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Kosovës në operacionet e NATO-s.

*Skenari i dytë:*

- Institucionet e Kosovës duhet të jenë të përgatitura për skenarin e dytë nëse dështon skenari i parë. Prandaj, ky skenar përqendrohet më shumë në thellimin e bashkëpunimit dypalësh me vendet anëtare të NATO-s. Kosova duhet të gjejë zgjidhje të tjera për t'ju qasur NATO-s përmes bashkëpunimit të ngushtë me vendet anëtare të saj që e kanë njohur Kosovën.
- Marrëveshjet dypalëshe ekzistuese dhe ato që pritet të bëhen duhet të përqendrohen në programe të trajnimit dhe ushtrimeve të përbashkëta të Forcave të Armatosura të Kosovës me forcat e armatosura të vendeve anëtare të NATO-s që e kanë njohur Kosovën.

- Kosova duhet të nënshkruajë marrëveshje dypalëshe me Shqipërinë dhe Kroacinë në mënyrë që të përfitojë dhe mësojë nga rastet e këtyre vendeve gjatë anëtarësimit të tyre në Partneritetin për Paqe dhe në NATO.
- Pasi Kosova të arrijë marrëveshje dypalëshe me vendet e NATO-s, institucionet e Kosovës mund të përmbushin njëanshëm kushtet dhe standardet e nevojshme për anëtarësim në NATO. Në këtë mënyrë, Kosova në njëfarë shkalle do të përgatitet kur të vijë deri tek kërkesa për anëtarësim në programin e Partneritetit për Paqe dhe në NATO.
- Qeveria e Kosovës duhet të rrit numrin e atasheve ushtarakë të Kosovës dhe të stafit diplomatik në ambasadat e Kosovës tek vendet e NATO-s që e kanë njohur Kosovën.

#### REKOMANDIMET:

- Politikëbërësit e Kosovës duhet të ndërmarrin reformat e nevojshme në mënyrë të menjëhershme për të vënë në praktikë synimin për të zhvilluar marrëdhëniet kontraktuale Kosovë-NATO. Institucionet e Kosovës duhet të përmbushin detyrat lidhur me integrimin në NATO në hartimin e dokumenteve të politikave dhe përgatitjen e vendit për anëtarësim në NATO.
- Institucionet e Kosovës duhet të kërkojnë nisjen e dialogut zyrtar me NATO-n që do të ishte i kufizuar në kohë dhe në njëfarë mënyre do ta përgatiste Kosovën për anëtarësim në programin e Partneritetit për Paqe dhe për hapat tjerët për anëtarësim në NATO. NATO duhet të marrë parasysh hapjen e dialogut zyrtar dhe të strukturuar ndërmjet Kosovës dhe NATO-s.
- Institucionet e Kosovës duhet kërkojnë hapjen e Zyrës Ndërlidhëse të Kosovës në selinë e NATO-s në Bruksel derisa Kosova zyrtarisht të ketë të drejtë të dërgojë zyrtarin e përherëshëm ndërlidhës në selinë e NATO-s në kuadër të programit të Partneritetit për Paqe dhe të themelojë Përfaqësinë e Përherëshme në selinë e NATO-s.
- Katër vendet e NATO-s - Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja - duhet të njohin Kosovën sa më parë. Duke marrë vendimin për njohjen e Kosovës, këto vende do të kontribuonin për paqen dhe stabilitetin afatgjatë në Ballkanin Perëndimor dhe përfundimisht do t'i hapnin rrugën Kosovës drejt integritit në NATO.
- Në arritjen e kapaciteteve për të qenë përgjegjëse për ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë për qytetarët dhe territorin e Kosovës, Forcat e Armatosura të Kosovës duhet të jenë të gatshme për të marrë detyrat nga KFOR-i duke e ditur që kjo e fundit nuk do të qëndrojë në Kosovë pafundësisht. Për më shumë, Forcat e Armatosura të Kosovës duhet të trajnohen profesionalisht sipas standardeve të NATO-s për ndërveprim për të qenë të gatshme të marrin pjesë në operacionet ndërkombëtare paqeruajtëse.

Rekomandimet tjera gjenden në raport në pjesën përkatëse të rekomandimeve.

Anëtarësimi i Kosovës në strukturat euro-atlantike, me theks të veçantë në NATO, u bë prioritet për institucionet e Kosovës tek në vitin 2014 kur u përfundua Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë. Diskursi politik në Kosovë, vazhdueshëm iu ka referuar anëtarësimit të vendit në strukturat euro-atlantike, duke përfshirë edhe NATO-n. Por pavarësisht kësaj, deri në kohët e fundit, angazhimi praktik në këtë drejtim ka ngelur vetëm në kufijtë e retorikës. Ky raport analizon marrëdhëniet e ndërlukuara që ekzistojnë në mes të Kosovës dhe NATO-s. Megjithatë, mungesa e bashkëpunimit zyrtar duhet të vështrohet nga dy pikëpamje. Në njërin anë, është shumë e qartë që gjatë viteve pas shpalljes së pavarësisë, Kosova nuk ka dëshmuar vullnet të vendosur politik për të kërkuar nisjen e bashkëpunimit zyrtar me NATO-n dhe me këtë të bëjë ndryshimin prej marrëdhënieve operative drejt vendosjes së marrëdhënieve politike me NATO-n. Politikëbërësit e Kosovës kanë treguar vetëm angazhim deklarativ në lidhje me integritet euro-atlantike, ani pse nuk është shënuar asnjë përparim në vendosjen e marrëdhënieve të Kosovës me NATO-n. Në anën tjetër, bllokimi që po i bëhet Kosovës nga ana e katër shteteve të NATO-s me mosnjohjen e pavarësisë së Kosovës, por edhe pengesat që burojnë nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara përbëjnë ndër sfidat kyçe për Kosovën që të ecë përpara për anëtarësim në NATO.

Ky raport synon të adresojë sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet Kosova për integrim në NATO. Por, gjithashtu si zgjidhje konkrete ofron dy skenarë për institucionet e Kosovës që duhet të merren në shqyrtim nga këto të fundit për të lëvizur përpara drejt procesit të anëtarësimit dhe vendosjes së marrëdhënieve kontraktuale me NATO-n. Mbi të gjitha, Kosova duhet të rishikojë kornizën e saj institucionale për integrim në NATO dhe me këtë të bëjë reforma të domosdoshme në mënyrë që të ketë bashkëpunim dhe koordinim sa më të mirë në mes të të gjitha institucioneve të vendit të përfshira në këtë proces. Për më shumë, fokusi i këtij raporti është që të ndikojë tek institucionet dhe politikëbërësit e Kosovës duke i inkurajuar ata që të ndërmarrin hapa të guximshëm për të nxitur bashkëpunimin e Kosovës me vendet mike të Kosovës në NATO, gjë që do të shënonte një pikë kthesë në marrëdhëniet e Kosovës me NATO-n.

Pjesa e parë e këtij raporti shqyrton kontekstin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe NATO-s që nga viti 1999 kur misioni paqeruajtës i NATO-s (KFOR) zbarkoi në Kosovë pas përfundimit të luftës për vendosjen së një ambienti të sigurt në vend. Kjo pjesë përfshin edhe rolin e KFOR-it në Kosovë pas periudhës së luftës dhe sfidat për të ofruar siguri në veriun e Kosovës nga ana e trupave të KFOR-it, duke përfshirë këtu edhe ngjarjet e trazirave gjatë marsit të vitit 2004. Gjithashtu, pjesa e parë e raportit i kushton rëndësi bartjes graduale të përgjegjësisë nga KFOR-i tek institucionet e sigurisë së Kosovës, si dhe zvogëlimin e trupave të KFOR-it. Pjesa e dytë vë në pah në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe analizon marrëdhëniet e ndërlukuara të Kosovës me NATO-n, prej periudhës së shpalljes së pavarësisë në vitin 2008 deri në vitin 2015. Kjo pjesë ka për qëllim të analizojë pengesat me të cilat Kosova ballafaqohet drejt vendosjes së dialogut me NATO-n dhe mungesën e gatishmërisë së institucioneve të Kosovës për t'u marrë me procesin e anëtarësimit në NATO. Pikësynimi i këtij raporti nuk është vetëm të identifikojë problemet dhe pengesat ekzistuese për këtë çështje, mirëpo gjithashtu ofron zgjidhje alternative për tejkalimin e rrugës pa krye drejt integritet të Kosovës në NATO. Prandaj, ky raport përfundon me ofrimin e dy skenarëve se si duhet Kosova të ecë përpara drejt integritet në NATO. Në mbështetje të kësaj, raporti përmban rekomandime të veçanta drejtuar institucioneve të Kosovës, NATO-s dhe shteteve mike të Kosovës në NATO me qëllim të nisjes dhe zhvillimit të dialogut ndërmjet të të dyja palëve.

---

## METODOLOGJIA

---

Për përpilimin me sukses të këtij raporti, autori ka përdorur dy metodat hulumtuese, ato kualitative dhe kuantitative. Të dhënat kualitative përfshijnë analizimin e thellë të dokumenteve të ndryshme me karakter juridik e politik, raporteve të organizatave vendore e ndërkombëtare dhe burime të tjera nga institucionet publike. Të dhënat shtesë janë grumbulluar nga realizimi i tetë intervistave të drejtpërdrejta me përfaqësuesit përkatës të institucioneve të Kosovës, duke përfshirë si në vijim: Forcën e Sigurisë së Kosovës, Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Zyrën e Kryeministrit të Kosovës dhe Zyrën e Presidentit të Kosovës. Gjithashtu, janë bërë intervista me përfaqësuesit diplomatikë të misioneve të huaja në Kosovë: Ambasadën Britanike në Prishtinë dhe Ambasadën e Kroacisë në Prishtinë. Ndërsa, një intervistë është realizuar edhe me korrespondentin e gazetës së përditshme “Koha Ditore” në Bruksel.

Ky hulumtim është mbështetur në sondazhin e opinionit publik të Barometrit Kosovar të Sigurisë, që është program i udhëhequr nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Botimi i katërt i Barometrit Kosovar të Sigurisë përmbante një pyetje për perceptimin e qytetarëve ndaj anëtarësimit në NATO, ku janë pyetur 1001 qytetarë në të gjitha rajonet e Kosovës. Në këtë mënyrë, ne kemi zbërthyer mbështetjen publike për sa i përket rrugës së Kosovës drejt NATO-s dhe kemi ofruar perspektivën krahasuese me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor që aspirojnë t’i bashkohen NATO-s.

## SEKSIONI 1 – ROLI I NATO-S NË KOSOVË GJATË PERIUdhës SË PASLUFTËS (1999-2008)

Marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), në kuadër të përgjegjësiave dhe synimeve të përbashkëta, filluan gjatë intervenimit humanitar të NATO-s në Kosovë dhe fushatës 78-ditëshe të sulmeve ajrore të NATO-s kundër Serbisë. Këto marrëdhënie u zhvilluan më tej pas luftës në Kosovë me zbarkimin e misionit paqeruajtës ushtarak të NATO-s në Kosovë (KFOR) nën administratën ndërkombëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Që nga ajo kohë, KFOR-it i ishte dhënë roli kryesor në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes në Kosovë. Misioni i saj buron nga Marrëveshja Teknike dhe Ushtarake (e njohur ndryshe edhe si Marrëveshja e Kumanovës), e cila ishte nënshkruar më 9 qershor 1999 në mes të NATO-s dhe përfaqësuesve të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ). Marrëveshja e Kumanovës kishte shërbyer si njëra nga kornizat juridike për Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (KSOKB), e cila është baza kryesore juridike për praninë e misionit të KFOR-it në Kosovë.

Marrëveshja e Kumanovës kishte paraparë vendosjen e KFOR-it pa asnjë pengesë në tërë territorin e Kosovës me qëllim të vendosjes dhe ruajtjes së ambientit të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës. Kjo marrëveshje gjithashtu kishte paraparë tërheqjen e të gjithë forcave jugosllave dhe serbe nga Kosova. Forcat serbe/jugosllave të sigurisë dhe të ushtrisë u tërhoqën nga Kosova më 20 qershor 1999 në pajtim me Marrëveshjen e Kumanovës (NATO, 2014a). Ajo bënte thirrje edhe për çmilitarizimin dhe çmobilizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për më shumë, kjo marrëveshje i referohej çështjeve në lidhje me zonën tokësore dhe ajrore të sigurisë ku forcat e uniformuara të sigurisë së RFJ-së nuk lejoheshin të operonin. Sipas kësaj marrëveshje, zona tokësore e sigurisë<sup>1</sup> përfshinte perimetrimin prej 5 kilometrave jashtë kufijve të Kosovës, ndërsa ajo ajrore përfshinte largësinë prej 25 kilometrave jashtë kufirit të Kosovës (NATO, 1999, fq. 1-2).

Në fillim KFOR-i përbëhej prej më shumë se 50,000 trupave që funksiononin në një zinxhir komandues nën autoritetin e Komandantit të KFOR-it (COMKFOR) që i raportonte Komandantit të Komandës së Forcave të Përbashkëta në Napoli të Italisë (NATO, 2014d). Misioni paqeruajtës gjithashtu lehtësoi procesin e kthimit të sigurt për të gjithë personat e zhvendosur dhe të refugjatëve (UNSCR 1244, 1999, fq. 2-8). Në periudhën fillestare, KFOR-i ishte i përfshirë edhe në operacione me nevojë të veçanta menjëherë pas përfundimit të luftës që përfshinin: përpjekjet për rindërtimin e infrastrukturës së shkatërruar, çminimin e zonave të minuara, ndihmën mjekësore, sigurinë dhe rendin publik, mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë, sigurinë e kufijve, ndalimin e kontrabandës ndërkufitare të armëve, zbatimin e një programi të gjerë të amnistisë në fushën e armëve, municionit dhe lëndëve shpërthyes, shkatërrimin e armëve dhe ofrimin e mbështetjes për themelimin e institucioneve civile, pra atyre të rendit e ligjit, të sistemit gjyqësor dhe atij penal. Gjithashtu, KFOR-i mori masa në fushën e sigurisë gjatë procesit zgjedhor dhe për aspekte të tjera politike, ekonomike dhe shoqërore në Kosovë (NATO, 2014a). Shumicën e detyrave, KFOR-i i kryente në bashkërendim me organizatat tjera ndërkombëtare, organizatat joqeveritare, autoritetet e Kosovës dhe duke i vënë në funksion strukturat e veta të

1 Megjithatë, prej vitit 2001 KFOR-i e ka hequr zonën tokësore të sigurisë prej 5 kilometrave në mes të Kosovës dhe Serbisë (NATO, 2001).

bashkëpunimit civil-ushtarak, siç ishin Ekipet e Ndërlidhjes dhe të Mbikëqyrjes<sup>2</sup> për të nxjerrë rezultate të prekshme në terren (Etchemendy, 2010, f. 6).

Sfida më e madhe gjatë kësaj periudhe kur u vendos KFOR-i ishte çështja e veriut të Kosovës. Forcat serbe të sigurisë atje i dëbuan shqiptarët prej shtëpive të tyre në Mitrovicë dhe me përkrahjen e Qeverisë serbe, bashkësia serbe në Kosovë vuri në jetë strukturat e veta paralele në fushën e sigurisë, arsimit, shëndetësisë dhe në çështjet tjera shoqërore-politike e shoqërore-ekonomike. Trupat franceze të KFOR-it, të cilat ishin të vendosura në veriun e Mitrovicës, menjëherë vendosën një kordon në urën mbi lumin Ibër duke kufizuar kështu lirinë e lëvizjes së qytetarëve ndërmjet jugut dhe veriut të Kosovës (International Crisis Group, 2005, f. 3). Prandaj, përveç administratës ndërkombëtare, institucionet e Kosovës nuk kishin qasje në veriun e Kosovës.

Këto ndarje dhe mungesa e qartësisë lidhur me statusin përfundimtar të Kosovës ngriti tensionet në mesin e shqiptarëve dhe kjo arriti kulmin kur në vend shpërthyen trazirat e dhunshme në mars të vitit 2004. Në të vërtetë, këto trazira nisën pas njoftimit në njërën nga mediat e Kosovës se tre fëmijë shqiptarë në veri të Mitrovicës ishin mbytur në lumin Ibër dhe një nga fëmijët që kishte shpëtuar pati pohuar se ata ishin sulmuar nga serbët e Kosovës (Qehaja & Vrajolli, 2011, f. 14). Një ditë më pas demonstrata të dhunshme shpërthyen në tërë Kosovën që përfunduan me 19 persona të vrarë (11 prej tyre ishin shqiptarë dhe 8 ishin serbë). Këto demonstrata u zgjeruan në trazira që çuan në shkatërrimin e shtëpive kryesisht të banuara nga serbë të Kosovës dhe djegien e disa kishave ortodokse (BBC, 2014). Megjithatë, roli i KFOR-it në këto trazira ishte kritikuar për shkak se nuk kishte reaguar me kohë për të ndaluar dhunën, derisa trupat e KFOR-it dukej të kishin qenë të papërgatitura për të reaguar në mënyrë efektive ndaj dhunës (Human Rights Watch, 2004, f. 28). Dhuna dëshmoi se KFOR-i nuk kishte strukturë për t'u ballafaquar me trazira të tilla të dhunshme.

Edhe pse ka kaluar një dekadë pas trazirave të marsit 2004 ende nuk ka një shpjegim të qartë se si ndodhën ato dhe aq më pak dihet se si u përhapën në tërë Kosovën. Pas këtyre ngjarjeve, KFOR-i mori përgjegjësinë për mbrojtjen dhe ruajtjen e objekteve të trashëgimisë fetare dhe kulturore në Kosovë, kryesisht ato të kishave ortodokse në Kosovë (Isufi, 2010). Duke e ditur që situata e sigurisë u përmirësua me kalimin e viteve, KFOR-i ka bartur gradualisht tek Policia e Kosovës (PK) përgjegjësinë për ruajtjen e këtyre objekteve. Mirëpo, Manastiri i Deçanit ende ka mbetur nën përgjegjësinë e KFOR-it si operacion fiks (NATO, 2014a), meqë selia e NATO-s ende nuk ka vendosur për të bartur përgjegjësinë tek PK-ja (Peci, 2010). Një arsye tjetër është se disa kushte ende ka nevojë të përmbushen për t'ia kaluar këtë përgjegjësi PK-së. Kjo e fundit, në anën tjetër, nuk e gëzon besimin e peshkopëve ortodoksë serbë të Manastirit të Deçanit (Telegrafi, 2012).

Viti 2005 shënoi fillimin e bartjes së vazhdueshme të përgjegjësisë nga administrata ndërkombëtare e OKB-së tek institucionet e Kosovës. Gjatë këtij viti u publikua Rishikimi i Sektorit për Siguri të Brendshme në Kosovë (RSSBK) – një proces që kishte për synim të vlerësojë kornizën institucionale dhe të propozojë arkitekturën e re të sigurisë në Kosovë (United Nations Development Programme, 2006, f. 13). Në vitin 2006, për herë të parë u bë dorëzimi i përgjegjë-

2 Ekipet e Ndërlidhjes dhe të Mbikëqyrjes funksiononin në kuadër të KFOR-it. Detyrat e tyre ishin mbledhja e informatave përmes takimeve me udhëheqësit kryesorë dhe qytetarët e Kosovës gjatë patrullimeve dhe vizitave në komunitete. Informatat e mbledhura dhe raportet e Ekipave të Ndërlidhjes dhe të Mbikëqyrjes shërbenin si bazë për COMKFOR-in sa i përket vendimeve operacionale (Mårtensson, 2013, fq. 14-15).

sive tek autoritetet e Kosovës në fushën e sigurisë dhe në këtë kohë u themeluan Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë. Po në këtë periudhë misioni i KFOR-it mbeti i pandryshuar duke pësuar disa përmirësime sa i përket efikasitetit të forcave dhe kapacitetit për të funksionuar në tërë Kosovën. Në përgjithësi, bashkëpunimi i KFOR-it me institucionet e Kosovës gjatë kësaj kohe ishte pozitiv duke marrë parasysh që ky mision luajti një rol të rëndësishëm duke mbështetur Trupat Mbrotjtëse të Kosovës (TMK) dhe Shërbimin Policor të Kosovës. Përveç kësaj, NATO dhe misioni i saj në Kosovë e kanë trajnuar dhe e kanë mbikëqyrur në baza ditore zhvillimin e TMK-së. Prej vitit 2008, KFOR-it i ishte dhënë detyra për të ndihmuar në shpërbërjen e TMK-së (NATO, 2014a), e cila zyrtarisht u shpërnda në vitin 2009 dhe rrjedhimisht i hapi rrugë krijimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

Përgjatë viteve dhe si rrjedhojë e përmirësimit të gjendjes së sigurisë, NATO-ja ka zvogëluar dukshëm praninë e saj në Kosovë. Kështu, KFOR-i e pakësoi praninë e saj nga 39,000 trupa në vitin 2002 në 17,500 sosh në vitin 2003 (NATO, 2014a). NATO-ja mori një vendim të rëndësishëm në vitin 2010 kur Aleanca vendosi për ta përshtatur praninë e saj në Kosovë, përkatësisht KFOR-i u zvogëluar në rreth 5,000 trupa gjithsejtë. Në të njëjtën kohë, KFOR-i mbetet i gatshëm për të vendosur forca në mënyrë të shpejtë dhe efikase kurdo dhe kudo që është e nevojshme duke përfshirë edhe trupat e forta rezervë (NATO, 2010). Sipas vlerësimeve të vitit 2015, KFOR-i ka më pak se 5,000 ushtarë në Kosovë prej gjithsejtë 31 vendeve që marrin pjesë në këtë mision paqeruajtës, përfshirë këtu vendet anëtare dhe joanëtare të NATO-s (NATO, 2015b). Mundësia për marrjen e ndonjë vendimi të ardhshëm për zvogëlimin e mëtejshëm të pranisë së trupave të KFOR-it do të bëhet kundrejt kritereve dhe treguesve të qartë, ndërsa qëndrimi i KFOR-it është i bazuar në kushte dhe jo sipas afateve të caktuara kohore (NATO, 2014b). Marrja e një vendimi të tillë kërkon miratimin e Këshillit Veri-Atlantik (KVA) të NATO-s.

Ndërkohë, një prej hapave të mëdhenj ishte bartja e përgjegjësi nga KFOR-i tek PK-ja për kontrollin dhe ruajtjen e kufijve të Kosovës. Përgjegjësia për kontrollin dhe mbikëqyrjen e vijës kufitare të Kosovës me tre prej katër vendeve fqinje të Kosovës (Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi) ishte bartur te PK-ja pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008. Megjithatë, vija kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë ende ka mbetur nën përgjegjësi të veçantë të trupave të KFOR-it për shkak të marrëdhënieve të ndjeshme të Kosovës me Serbinë dhe marrëdhënieve të tendosura ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë. Problem i madh veçanërisht është paraqitur të jetë vija e gjelbër e kufirit lindor të Kosovës me Serbinë, e cila është nën kontrollin e KFOR-it. Sipas shqetësimeve të shprehura nga banorët e fshatit Karaçevë, gjatë vitit 2014 Policia serbe ka provokuar banorët e fshatit në disa raste të ndryshme duke shkelur kështu Marrëveshjen e Kumanovës dhe duke hyrë në mënyrë të paligjshme brenda territorit të Kosovës (Sadiku, 2014). Kjo shkelje nga ana e Serbisë vazhdon të pasqyrohet në shqetësimin dhe frikën e banorëve të atij rajoni që shpesh ka çuar deri tek protestat e banorëve që kanë kërkuar prej KFOR-it dhe institucioneve të Kosovës t'i zgjidhin ankesat e tyre në mënyrë të drejtë (Telegrafi, 2014).

Rrethana të reja u krijuan në vend të cilat u nxitën nga ngjarjet që ndodhën në Kosovë gjatë vitit 2008. Dështimi i negociatave të Vjenës për statusin e Kosovës ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (2005-2007); shpallja e pavarësisë nga Kuvendi i Kosovës në shkurt të vitit 2008; dhe sfidat e brendshme e të jashtme pas pavarësisë e ndryshuan kontekstin politik dhe të sigurisë në Kosovë. Seksioni tjetër shqyrton marrëdhëniet e institucioneve të Kosovës me KFOR-in, përkatësisht NATO-n ndërmjet viteve 2008 dhe 2015.



## SEKSIONI 2 – MARRËDHËNIET E KOSOVËS ME NATO-N (2008-2015)

Përprjekjet ndërkombëtare për gjetjen e një zgjidhjeje lidhur me statusin e Kosovës përmes negociatave të Vjenës që u ndërmjetësuan nga OKB-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë u dëshmuar se ishin të pasuksesshme. Megjithatë, roli i NATO-s gjatë kësaj periudhe ishte i rëndësishëm në përbushjen e detyrave për ruajtjen e sigurisë dhe paqes në Kosovë, por edhe në ofrimin e mbështetjes politike për negociatat Kosovë-Serbi. Për shembull, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s në atë kohë ka marrë pjesë në takimet e Grupit të Kontaktit që mbikëqyrte dhe përkrahte negociatat për statusin e ardhshëm të Kosovës. Gjatë këtyre takimeve ministrat e Grupit të Kontaktit ritheksonin angazhimin e NATO-s për të garantuar një ambient të qetë dhe të sigurt përmes KFOR-it (UNOSEK, 2006a, f. 2). Ata gjithashtu mirëpritnin planin e NATO-s për vazhdimin e pranisë së saj ushtarake ndërkombëtare në Kosovë edhe pas zgjidhjes së statusit (UNOSEK, 2006b, f. 2). KFOR-i ndihmoi në ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë duke bërë të mundur që negociatat të zhvilloheshin pa ndonjë shqetësim se situata e sigurisë në Kosovë mund të përshkallëzohej. Në fund të vitit 2007, ministrat e Jashtëm të vendeve anëtare të NATO-s u pajtuan që KFOR-i do të qëndronte në Kosovë sipas Rezolutës 1244 derisa KSOKB-ja nuk vendos ndryshe dhe, si pasojë e kësaj, ata e përsëritën edhe më shumë angazhimin e tyre për mbajtjen e forcave të KFOR-it në Kosovë, duke përfshirë edhe forcat rezervë, në shkallën që ishin të pranishme në terren në atë kohë dhe se kjo prani do të vazhdonte pa ndonjë paralajmërim të ri (NATO, 2014c). Përkundër frikës prej kërcënimeve të mundshme ndaj sigurisë që do të mund të vinin prej ndonjë konflikti ndëretnik të paparashikuar, ishin regjistruar vetëm disa demonstrata në shkallë të vogël (Qehaja & Vrajolli, 2011, f. 21).

Pas dështimit të negociatave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Kuvendi i Kosovës shpalli Deklaratën e Pavarësisë më 17 shkurt 2008 në pajtim të plotë me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i njohur ndryshe edhe si Plani i Ahtisaarit. Një ditë pas shpalljes së pavarësisë, KVA-ja e NATO-s nxori një deklaratë e cila ka betonuar tërësisht pozicionin dhe qasjen neutrale të NATO-s ndaj statusit të Kosovës së pavarur prej vitit 2008. Kjo deklaratë e NATO-s vuri në pah dhe ripohoi se KFOR-i do të qëndrojë në Kosovë sipas Rezolutës 1244, siç ishin pajtuar ministrat e Jashtëm në dhjetor të vitit 2007, përderisa KSOKB-ja të vendosë ndryshe, si dhe mbeti e pandryshueshme përgjegjësia dhe zotimi i NATO-s për garantimin e ambientit të qetë dhe të sigurt në Kosovë (NATO, 2008a). Pra, ndryshimi i peizazhit politik në Kosovë në vitin 2008 nuk solli asnjë ndryshim në marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe NATO-s. Kjo e fundit e ruajti praninë e vet në Kosovë sipas Rezolutës 1244. NATO vazhdoi të funksionojë sipas kësaj rezolute pa e ndryshuar statusin dhe përgjegjësinë e saj, meqë jo të gjitha vendet anëtare të saj e njohën Kosovës pas shpalljes së pavarësisë në shkurt të 2008-s. Qëndrimi neutral i NATO-s ndaj pavarësisë së Kosovës e sfidoi rrugën e anëtarësimit të Kosovës në NATO.

### 2.1. Katër vendet mos-njohëse

Marrëdhëniet dhe komunikimi në mes të Kosovës dhe NATO-s vazhdoi, ndonëse me dykuptimësi duke e marrë parasysh në njërën anë se Kosova filloi të funksionojë në pajtim me statusin dhe Kushtetutën e re, kurse në anën tjetër NATO-ja e ruajti qëndrimin neutral përballë statusit të ri të Kosovës. Prej perspektivës së NATO-s ky bashkëpunim ka ndodhur nën kornizën e Rezolutës 1244,



me përjashtim të mbështetjes së dhënë për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), ku NATO kontribuon përmes Ekipit Këshillëdhënës të NATO-s (EKN) dhe në FSK përmes Ekipit Ndërlidhës dhe Këshillëdhënës të NATO-s (ENKN). Megjithatë, ky bashkëpunim nuk ka çuar tek vendosja e marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet Kosovës dhe NATO-s për shkak të faktit se jo të gjitha vendet anëtare të NATO-s e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja janë katër Vendet Mos-Njohëse (VMN) prej gjithsejtë 28 vendeve të NATO-s që vazhdojnë të refuzojnë pavarësinë, kurse mosnjohja në këtë rast po e vështirëson procesin e anëtarësimit të Kosovës në NATO. VMN-të refuzojnë të njohin Kosovën me arsyetimin se pavarësia e saj ishte shpallur në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe Rezolutën 1244. Megjithatë, përkundër Mendimit Këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë që, më 22 korrik 2010, erdhi në përfundimin se shpallja e pavarësisë nuk cenonte të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare dhe Rezolutën 1244 të KSOKB-së, VMN-të e NATO-s prapëseprapë nuk lëvizën përpara drejt njohjes së Kosovës (International Court of Justice, 2010, f. 53).

Sidoqoftë, këto katër vende kanë edhe arsye të tjera pse nuk e njohin Kosovën. Për shembull, pozicioni i Spanjës ndaj pavarësisë së Kosovës nuk është i ndërlidhur me zhvillimet në Kosovë, por është i lidhur drejtpërdrejt me problemet e brendshme të autoriteteve spanjolle që ballafaqohen me vullnetin e popullit të shtetit bask dhe të Katalonisë për të shpallur pavarësinë nga Spanja (Fanés, 2012, f. 13). Përderisa Spanja në veçanti mban një diskurs të fortë kundër shtetësisë së Kosovës që mund t'i shkaktojë sfida serioze qëllimit të Kosovës për t'u anëtarësuar në NATO, tre VMN-të tjera kanë ndërmarrë një hap pozitiv dhe të rëndësishëm për ndërtimin e marrëdhënieve të mira me Kosovën kur morën vendimin për njohjen e pasaportave të Kosovës. Megjithatë, zyrtarisht edhe këto vende i kanë arsyet e veta për mosnjohjen e Kosovës. Pas pavarësisë së Kosovës, politikanët sllovakë konstatuan se ekziston rreziku që pakica hungareze në Sllovaki të shkëputet dhe me këtë t'i bashkëngjitet Hungarisë (Hurn, 2008). Kundërshtimi i Rumanisë ndaj statusit të Kosovës vihet në pah prej frikës se pakica hungareze në krahinën e Transilvanisë mund të bëjë përpjekje për shkëputje nga Rumania (Marinas, 2008). Ndërsa, qëndrimi zyrtar i Greqisë është se statusi i Kosovës duhet të zgjidhet përmes diplomacisë dhe konsensusit me qëllim të ndërtimit të një ambienti paqësor dhe të mirëqenë për të gjithë popujt e rajonit duke marrë parasysh të drejtat e njeriut, liritë themelore dhe mbrojtjen e pakicave (Armakolas & Karabairis, 2012, f. 112). Për më shumë, në krahasim me VMN-të tjera të NATO-s, pozicioni i Greqisë ndaj Kosovës ka qenë më optimist gjatë këtyre viteve.<sup>3</sup>

Ajo që duhet të përmendet është se disa prej këtyre VMN-ve kanë marrëdhënie të forta tradicionale, fetare dhe kulturore me Serbinë, e cila në mënyrë të vendosur nuk e pranon pavarësinë e Kosovës. Përkundër kësaj, rasti i Kosovës është i veçantë, i ndryshëm dhe aspak nuk është i ngjashëm me rajonet tjera që kërkojnë të shpallin pavarësinë. Prandaj, shembulli i Kosovës nuk mund të shërbejë si rast që mund të pasohet prej vendeve të tjera. Pavarësisht kundërshtimit për të njohur Kosovën, VMN-të e përkrahin dialogun politik në mes të Kosovës dhe Serbisë, i cili lehtësohet nga Bashkimi Evropian (BE) që ka për qëllim normalizimin e marrëdhënieve në mes të të dyja palëve.

3 Edhe pse shefja e Zyrës Ndërlidhëse të Greqisë në Prishtinë, Konstantina Athanasiadou, ka thënë se vendi i saj nuk e njeh Kosovën, megjithatë, sipas saj, në të njëjtën kohë Greqia nuk e përjashton mundësinë që një të ardhme të njohë pavarësinë e Kosovës. Në janar të vitit 2015, ajo ka nënvizuar që në kohën e duhur Greqia do të marrë vendimin e duhur, duke shtuar se Kosova ka perspektivë të qartë euro-atlantike (AAB, 2015).

Ani pse nuk e njohin pavarësinë, VMN-të e NATO-s kanë dhënë kontribut të rëndësishëm përmes pranisë së trupave të tyre në misionin paqeruajtës të KFOR-it në rajone të ndryshme të Kosovës. Përderisa Greqia dhe Rumania vazhdojnë të mbajnë trupat e tyre në Kosovë, Spanja dhe Sllovakia kanë vendosur t'i tërheqin trupat nga Kosova në vitin 2009, përkatësisht më 2010. Në të vërtetë, sipas zyrtarëve të Qeverisë spanjolle, tërheqja e 600 ushtarëve spanjollë nga Kosova kishte ndodhur për shkak se misioni i trupave spanjolle kishte përfunduar dhe ishte konstatuar se "ka ardhur koha për t'u kthyer në vendlindje" (BBC, 2009). Në mënyrë të ngjashme edhe Sllovakia ka bërë tërheqjen e trupave të veta nga KFOR-i me arsyetimin se misioni i tyre në Kosovë ka marrë fund. Duke u bazuar tek zyrtarët e lartë të autoriteteve sllovake "kontrata ishte e vlefshme deri në vjeshtë të vitit 2010" dhe se Sllovakia i ka përmbushur zotimet e veta në Kosovë (The Slovak Spectator, 2010a). Nuk ka ndonjë arsye tjetër që këto vende t'i kenë tërhequr trupat e tyre nga Kosova, pos arsyeve ushtarake. Sllovakia i tërhoqi trupat për shkak se kërkonte t'i rivendoste ato në misionin e NATO-s në Afganistan, derisa edhe Spanja gjendej nën trysni për të vepruar ngjashëm (Burnett, 2009). Një arsye tjetër është se ngarkesat financiare dhe kufizimet buxhetore të të dyja vendeve kanë ndikuar në vendimet e tyre për tërheqjen e trupave nga misioni i NATO-s në Kosovë (Vrajolli & Kallaba, 2012, f. 11).

Zyrtarët e lartë të këtyre vendeve, duke përfshirë kryeministren e Sllovakisë (shtator 2010), ministren spanjolle të Mbrojtjes (mars 2009) dhe kryeministrin rumun (nëntor 2014) kanë vizituar Kosovën, në veçanti misionin e KFOR-it dhe bazën e trupave të tyre në Kosovë. Por zyrtarët e këtyre vendeve, të paktën zyrtarisht, asnjëherë nuk janë takuar me homologët e tyre nga ana e institucioneve të Kosovës.<sup>4</sup> Kjo dëshmon që çështja e mosnjohjes së pavarësisë nga këto vende ka penguar çfarëdo bashkëpunimi zyrtar në mes të Kosovës dhe VMN-ve. Qëndrimi i këtyre të fundit ndaj Kosovës dhe mëdyshjet e tyre për të vendosur kontakt me autoritetet e Kosovës tregon që ato mund të jenë palë bllokuese brenda NATO-s për sa i përket mundësisë së pjesëmarrjes së Kosovës në programet dhe partneritetet e NATO-s.

Por, siç do të analizohet më tutje në këtë raport, as institucionet e Kosovës nuk kanë ndonjë plan, strategji apo të paktën një dokument se si t'i qasen dhe të bashkëpunojnë me këto vende në fushat përkatëse, pavarësisht çështjes së mosnjohjes.

## 2.2. Marrëdhëniet aktuale ndërmjet Kosovës dhe NATO-s

Ndonëse NATO-ja është e përfshirë në Kosovë prej 15 vitesh dhe përkundër faktit që të gjitha vendet fqinje të Kosovës i janë bashkuar programit Partneriteti për Paqe (PpP) të NATO-s, Kosova është vendi i vetëm që ka mbetur jashtë procesit të zgjerimit të NATO-s. Kosova nuk ka vendosur ndonjë marrëdhënie zyrtare, dypalëshe apo kontraktuale me NATO-n dhe, për më shumë, është vendi i

4 Për shembull, kryeministrja e Sllovakisë, Ivetta Radičová, vizitoi Kosovën në shtator të vitit 2010, ku u takua me kontingjentin e ushtarëve sllovakë të KFOR-it dhe me COMKFOR-in, por ajo nuk u takua edhe me kryeministrin e atëhershëm të Kosovës apo me përfaqësues të tjerë të institucioneve të Kosovës (The Slovak Spectator, 2010b). Ministrja spanjolle e Mbrojtjes, Carme Chacón vizitoi trupat e Spanjës në KFOR gjatë marsit të vitit 2009, por nuk ka ndonjë informata që ajo të ketë zhvilluar ndonjë takim me homologun e saj nga Qeveria e Kosovës (Burnett, 2009). Ndërsa, në nëntorin e 2014-s, kryeministri i Rumanisë, Victor Ponta dhe ministri rumun i Mbrojtjes Kombëtare, Mircea Dusa, u takuan me COMKFOR-in në Shtabin e Përgjithshëm të KFOR-it. Ata konfirmuan se Rumania do të vazhdojë të përkrahë misionin e KFOR-it dhe dialogun politik në mes të Kosovës dhe Serbisë (NATO, 2014e), por ngjashëm si delegacionet tjera të VMN-ve, ata nuk kishin planifikuar takime edhe me përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës.

vetëm në Ballkanin Perëndimor që nuk ka asnjë bashkëpunim me KVA-në e NATO-s. Gjithashtu, sa i përket bashkëpunimit me NATO-n, Kosova, përkatësisht institucionet dhe mekanizmat e saj janë të bllokuara në të gjitha aspektet duke mos e gëzuar të drejtën e pjesëmarrjes në mekanizmat bashkëpunues dhe programet e ndryshme të NATO-s, si pasojë e qëndrimit neutral të kësaj të fundit ndaj Kosovës.

Përderisa integrimet euro-atlantike përmenden në mënyrë të vazhdueshme si synim i institucioneve të Kosovës, atëherë është me dobi të krahasohet integrimi i mundshëm i Kosovës në NATO me integrimin në BE. Në krahasim me synimin për anëtarësim në NATO, Kosova, së paku, deri diku ka shënuar përparim lidhur me procesin e anëtarësimit në BE. Në këtë drejtim, Kosova ka inicializuar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit; ka hyrë në dialog të strukturuar me BE-në për sundimin e ligjit dhe është e përfshirë në programet e BE-së që janë të dedikuara për Ballkanin Perëndimor. Në BE janë gjithashtu disa VMN që e pengojnë Kosovën të përparojë drejt integritit në BE; megjithatë, është struktura organizative e BE-së, ajo e cila për dallim prej asaj të NATO-s, ia mundëson Kosovës të shënojë sadopak përparim. Pos kësaj, BE-ja ka qenë më aktive në proceset politike të Kosovës dhe në formësimin e aspekteve shoqërore-politike në krahasim me NATO-n, e cila e ka lënë anash Kosovën për sa i përket procesit të anëtarësimit.

Ka një mori arsyes pse Kosova nuk është në të njëjtin ritëm të procesit të anëtarësimit drejt NATO-s në krahasim me përpjekjet e saja për integrim në BE. Së pari, misioni i NATO-s në Kosovë është i përcaktuar prej Rezolutës 1244 të KSOKB-së, e cila nuk është shfuqizuar. Me fjalë të tjera, NATO-ja vazhdon të interpretojë ngushtësisht këtë Rezolutë të OKB-së duke i shpërfillur rrethanat e reja në terren dhe realitetin e ri politik në Kosovë që nga viti 2008 (Palokaj, 2014). Së dyti, qëndrimi i VMN-ve të NATO-s për statusin e Kosovës e ka penguar synimin e kësaj të fundit për të nisur marrëdhëniet zyrtare me NATO-n dhe për shkak të strukturës organizative të NATO-s, VMN-të kanë qenë më të efektshme duke e bllokuar lëvizjen e Kosovës drejt anëtarësimit në NATO sesa në raport me marrëdhëniet me BE-në. Së treti, gjatë viteve 2008 dhe 2012, Kosova ishte nën mbikëqyrje ndërkombëtare dhe ende ishte duke e fuqizuar procesin e shtetësisë. Kështu që, gjatë kësaj periudhe nuk ishte shënuar asnjë përparim në drejtim të ndonjë bashkëpunimi zyrtar me NATO-n, duke e marrë parasysh që institucionet e Kosovës kishin disa kufizime lidhur me politikat në fushën e mbrojtjes. Më në fund, prej shtatorit të vitit 2012, diskursi i politikëbërësve të Kosovës për anëtarësim në NATO ka qenë kryesisht deklarativ. Integrimi euro-atlantik u ishin referuar vetëm në kuadër të kufijve të diskursit politik, derisa kishin munguar angazhimi konkret dhe rezultatet e qarta për anëtarësimin e mundshëm të Kosovës në NATO.

Rruga e Kosovës drejt anëtarësimit në BE dhe në NATO dallon edhe në një aspekt tjetër. Serbia, e cila nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës, ka shprehur synimin për t'ju bashkuar BE-së dhe prej vitit 2014 BE-ja ka nisur zyrtarisht negociatat për anëtarësim me Serbinë (European Commission, 2014). Mirëpo, BE-ja dhe disa shtete anëtare të saj kanë kushtëzuar anëtarësimin e Serbisë në BE me normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën sipas parimit të bashkëpunimit rajonal (Maksimovic, 2014). Në këtë mënyrë, BE-ja mund të ndikojë tek Serbia, por edhe tek shtetet anëtare të saj që nuk e kanë njohur Kosovën, të zbusin qëndrimin e tyre për sa i përket synimit të Kosovës për t'u integruar në BE. Ndërkohë, situatë tërësisht e kundërt mbretëron sa i përket integritit në NATO, meqë Kuvendi i Serbisë prej vitit 2007 ka nxjerrë një rezolutë përmes së cilës ka shpallur statusin e neutralitetit ushtarak të Serbisë ndaj integritit në NATO (B92, 2007). Rrjedhimisht, Serbia së paku zyrtarisht nuk ka ndonjë qëllim për integrim në NATO, gjë që në anën tjetër e bën më të vështirë

për NATO-n të kushtëzojë Serbinë dhe në veçanti të ushtrojë tryzni tek VMN-të e NATO-s që të zbusin qëndrimet e tyre lidhur me synimin e Kosovës për t'ju bashkuar NATO-s.

Është e qartë që prej vitit 2012 deri në vitin 2014, institucionet e Kosovës kanë vënë theksin më shumë tek integrimi në BE sesa në NATO dhe rrjedhimisht nuk kanë dëshmuar kurrfarë vullneti politik për të hyrë në marrëdhënie zyrtare me NATO-n dhe vendi të bëhet pjesë e programit të PpP-së. Në të vërtetë, institucionet që janë të angazhuara për integrimin e vendit në NATO janë krijuar tek në vitin 2008 pas pavarësisë, që nënkupton se ato ishin kryesisht të reja për t'u marrë me këtë çështje. Korniza institucionale e Kosovës që ka për përgjegjësi të merret me procesin e anëtarësimit në NATO ende nuk është përfunduar dhe madje edhe institucionet ekzistuese kanë dëshmuar se janë shumë mbrapa sa i përket anëtarësimit të vendit në NATO. Ato ballafaqohen me mungesë të kapaciteteve të brendshme dhe mungesën e burimeve njerëzore. Departamenti për NATO dhe Politika të Sigurisë (DNPS) në Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ) nuk ka nxjerrë një dokument apo strategji kombëtare për veprimet që do të nxitnin procesin e anëtarësimit në NATO. Një strategji e tillë është e nevojshme për krijimin e politikave të cilat institucionet e ndryshme do të duhej t'i ndjekin lidhur me integrimin në programin e PpP-së dhe në NATO. Mirëpo, kjo dëshmon se procesi i anëtarësimit në NATO nuk ka qenë prioritet për institucionet e Kosovës. Prandaj, përveç sfidave që dalin nga Rezoluta 1244 e KSOKB-së dhe nga VMN-të e NATO-s, edhe dështimi i institucioneve përkatëse të Kosovës, veçanërisht i MPJ-së, për të ndërmarrë hapa seriozë në drejtim të anëtarësimit në NATO është një pengesë tjetër në këtë drejtim.<sup>5</sup> Madje, Kosova ka bërë më shumë përpjekje për të lëvizur drejt agjendës së anëtarësimit në BE, kurse në të njëjtën kohë ka dështuar të kërkojë nga shtetet e saja mike në NATO të shtyjnë përpara agjendën e anëtarësimit të vendit në NATO. Është e rëndësishme të përmendet që vetëm në vitin 2014, Kosova e ka parashtruar qëllimin për t'ju bashkuar NATO-s si vizion dhe prioritet i institucioneve të saj që përmendet në Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS) (Qeveria e Kosovës, 2014, f. 7). Një prej synimeve të RSSS-së është integrimi dhe anëtarësimi i Kosovës në strukturat euro-atlantike duke qenë përfitues dhe kontribuues. RSSS-ja i referohet transformimit shkallë-shkallë të FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK) me qëllim të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës, ndërsa MFSK-ja do të riemërtohet në Ministri të Mbrojtjes (MM) dhe do të ketë përgjegjësi për ushtrimin e kontrollit civil e demokratik mbi FAK-un.<sup>6</sup> Një qëllim tjetër i RSSS-së është përgatitja e kapaciteteve të institucioneve përkatëse për të dhënë kontribut për paqen dhe operacionet humanitare, si edhe në misionet tjera ndërkombëtare të NATO-s (Qeveria e Kosovës, 2014, fq. 20-31). Sidoqoftë, qëllimet dhe rekomandimet e RSSS-së për FAK-un ende nuk janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Kjo u pamundësua nga shkaku i krizës politike në vend gjatë pjesës së dytë të vitit 2014, ndërsa pritet të dërgohen gjatë vitit 2015.

Përkundër pamundësisë së Kosovës që në mënyrë të pavarur të shtyjë përpara çështjen e hyrjes në marrëdhënie zyrtare me NATO-n, megjithatë disa vende anëtare të NATO-s kanë kërkuar dhe këmbëngulur se Kosova duhet të ecë përpara për t'u anëtarësuar në NATO. Më 5 shkurt 2014, një grup i anëtarëve të Kongresit të SHBA-së (Shteteve të Bashkuara të Amerikës), duke përfshirë Michael Turner dhe Eliot L. Engel, kanë nënshkruar një letër të cilën ia kanë drejtuar Sekretarit amerikan të Shtetit, John Kerry, lidhur me përfshirjen e Kosovës për anëtarësim në

5 Për më shumë hollësi lidhur me kornizën institucionale të Kosovës kundrejt integritetit në NATO, shih Tabelën 1 në Listën e Aneksëve.

6 Për më shumë hollësi për FAK-un, shih nën-seksionin 2.3.

PpP.<sup>7</sup> Ata kanë kërkuar prej Sekretarit Kerry të punojë me vendet anëtare mike të NATO-s që Kosovës, sikundër fqinjëve të saj, t'i garantohet pjesëmarrja në PpP si anëtare dhe t'i garantohet rruga e anëtarësimit të mundshëm në NATO. Madje, ata kanë konstatuar se Kosova duhet të ketë rrugë të qartë sa i përket integritet në Aleancë (Engel, 2014). Edhe përfaqësues të lartë të NATO-s dhe të vendeve të saja anëtare kanë deklaruar vazhdimisht se vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë Kosovën, kanë të ardhme euro-atlantike.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, vizitoi Prishtinën në janar të vitit 2015. Përveç takimit me COMKFOR-in në Shtabin e Përgjithshëm të KFOR-it, ai pati takime edhe me udhëheqësit e institucioneve të Kosovës, duke përfshirë presidenten, kryeministrin, ministrin e FSK-së dhe ish-komandantin e FSK-së. Madje, presidentja Atifete Jahjaga e priti me nderime shtetërore Sekretarin Stoltenberg (Zyra e Presidentit të Kosovës, 2015). Stoltenberg solli porosi pozitive nga Brukseli kur konstatoi që Kosova duhet të lëvizë përpara drejt paqes dhe mirëqenies për të fituar të ardhmen e saj brenda bashkësisë euro-atlantike dhe rrjedhimisht është e mirëpritur të marrë pjesë në mekanizmat bashkëpunues euro-atlantikë (NATO, 2015a). Megjithatë, ai nuk iu referua asnjëherë synimeve të Kosovës drejt integritet në NATO. Në anën tjetër, shefi NATO-s, deklaroi se KFOR-i do të qëndrojë në Kosovë në bazë të plotësimit të kushteve dhe jo sipas afateve kohore, gjë që nënkupton se institucionet e Kosovës do t'i marrin përgjegjësitë e plota nga KFOR-i vetëm atëherë kur NATO-ja vlerëson se do të tërhiqet nga Kosova. Gjithashtu, Stoltenberg i ka dhënë mbështetje dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë që lehtësohet nga BE-ja për një të ardhme më të mirë për të dyja vendet (NATO, 2015c). Kurse, udhëheqësit e Kosovës, gjatë kësaj vizite, kanë kërkuar partneritet në mes të Kosovës dhe NATO-s. Presidentja Jahjaga ka nënvizuar se institucionet e Kosovës dhe NATO-ja duhet të punojnë në partneritet të plotë për zhvillimin e forcave të Kosovës në pajtim me standardet e NATO-s dhe se ky partneritet duhet të shndërrohet në marrëdhënie kontraktuale ndërmjet Kosovës dhe NATO-s (Zyra e Presidentit të Kosovës, 2015).

Ndërsa, zyrtarët e lartë të MFSK-së kanë theksuar se Kosova kërkon të vendosë partneritet me NATO-n, derisa rruga dhe synimi i saj në fund të fundit është që të bëhet anëtare e NATO-s me të drejta të plota. Sipas një komunikate për media të MFSK-së, ministri Haki Demolli ka kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, hapjen e dialogut politik ndërmjet Kosovës e NATO-s, kurse mënyra më e mirë, sipas tij, për zhvillimin e këtij dialogu do të ishte nëse NATO-ja e emëron një Përfaqësues Special, i cili do ta udhëhiqte dialogun (MFSK, 2015). Për të shënuar përparim drejt PpP-së, përfaqësuesit e lartë të MFSK-së kanë bërë thirrje se institucionet përkatëse të Kosovës, më saktësisht MPJ-ja, në emër të Kosovës duhet të përgatisë Planin e Veprimit për Partneritet Individual (PVPI) dhe ta dorëzojë atë në NATO. Sipas ministrit Demolli, PVPI-ja duhet të theksojë rëndësinë e zhvillimit të kapaciteteve ndërvepruese të FSK-së. Nëse NATO e miraton PVPI-në për Kosovën, atëherë hapet rruga që FSK-ja ose FAK-u në të ardhmen të anëtarësohet në PpP (Kuvendi i Kosovës, 2015, f. 3). Mirëpo, problemi qëndron në

7 PpP-ja është hapi i parë dhe kryesor për rrugën e një vendi që ka për qëllim t'i bashkohet NATO-s. Ky është një bashkëpunim praktik dypalësh ndërmjet vendeve partnere euro-atlantike dhe NATO-s, që ju krijon hapësirë partnerëve të ndërtojnë marrëdhënie të veçantë me NATO-n duke i zgjedhur prioritetet për bashkëpunim. PpP ka nisur në vitin 1994 përmes Samitit të NATO-s në Bruksel me qëllim të rritjes së bashkëpunimit dhe stabilitetit në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore ndërmjet vendeve partnere përkatëse dhe NATO-s. Praktikisht aktivitetet e PpP-së prekin çdo fushë të aktivitetit të NATO-s, duke përfshirë çështje që lidhen me mbrojtjen, reformën e mbrojtjes, politikën e mbrojtjes dhe planifikimin, marrëdhëniet civile-ushtarake, edukimin dhe trajnimin, bashkëpunimin dhe ushtrimet ushtri me ushtri, planifikimin e emergjencave civile dhe reagimin ndaj fatkeqësive, si edhe bashkëpunimin në çështjet e shkencës dhe të ambientit (NATO, 2014g).

atë se politikëbërësit e Kosovës i kanë bërë këto kërkesa vetëm në mënyrë deklarative gjatë takimeve me përfaqësuesit e lartë të NATO-s; përtej kësaj, Kosova asnjëherë nuk ka bërë një kërkesë të tillë zyrtare në drejtim të autoriteteve të NATO-s.

Këto nuk janë pengesat dhe çështjet e vetme që e kanë lënë mbrapa Kosovën në marrëdhëniet e saja me NATO-n. Sipas zyrtarëve të lartë të institucioneve të Kosovës, anëtarësimi në NATO mund të kushtëzohet prej anëtarësimit të vendit në OKB. Kjo është problematike duke marrë parasysh që dy anëtarë të përhershëm të KSOKB-së, Rusia dhe Kina, e kundërshtojnë fuqishëm pavarësinë e Kosovës. Sidoqoftë, gjatë raportimit të tij para Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Kosovës, më 9 shkurt 2015, ministri Demolli ka thënë se dokumentet zyrtare të NATO-s nuk përmendin saktësisht nëse një vend i cili synon t'i bashkohet NATO-s duhet të jetë edhe shtet anëtar i OKB-së (Kuvendi i Kosovës, 2015, f. 3). Gjithashtu, duke u bazuar në disa dokumente zyrtare të NATO-s, duke e përfshirë Studimin për Zgjerim të vitit 1995 dhe në deklarimet e zyrtarëve të lartë të institucioneve të Kosovës, anëtarësimi i vendit në PpP mund të kushtëzohet paraprakisht edhe prej anëtarësimit në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Meqë Kosova nuk është vend anëtar i OSBE-së, kjo mund të shkaktojë një tjetër pengesë për Kosovë që të bëhet pjesë e PpP-së.

Pavarësisht prej këtyre sfidave, ekzistojnë disa mundësi për Kosovën se si të vendosë bashkëpunim zyrtar me NATO-n. Për shembull, në gusht të vitit 2014, ministri për Punë të Jashtme i Letonisë, Edgars Rinkēvičs, ka vënë në pah se "dialogu i strukturuar me NATO-n është i mundshëm" dhe ka shtuar se në rast se Kosova dhe vendet anëtare të NATO-s janë të gatshme për bashkëpunim, atëherë "dialogu i strukturuar dhe zyrtar mund të zhvillohet" (Koha Net, 2014a). Madje, si një shembull të mirë ai e ka marrë dialogun e strukturuar të Kosovës me BE-në dhe ka propozuar që një dialog i tillë duhet të zhvillohet edhe me NATO-n. Në të vërtetë, deklarata e ministrit letonez duhet të shihet si një shenjë e mirë drejt nevojës së Kosovës për t'u përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në mekanizmat bashkëpunues të NATO-s. Në anën tjetër, sa i përket bashkëpunimit me vendet anëtare të NATO-s, MFSK-ja ka arritur një mori marrëveshjesh dypalëshe, përkatësisht, memorandume të bashkëpunimit<sup>8</sup>, plane vjetore dypalëshe, partneritetet shtetëror<sup>9</sup> dhe memorandume për Marrëveshjen e Statusit të Forcave (SOFA)<sup>10</sup> me

8 Nga viti 2012 deri në vitin 2015, MFSK-ja ka nënshkruar memorandume të bashkëpunimit me Shqipërinë, Kroacinë, Letoninë, Gjermaninë, Maqedoninë, Slloveninë, Turqinë, Suedinë dhe SHBA-në. Këto memorandume prekin çështje të ndryshme, duke përfshirë: mbrojtjen dhe sigurinë në mes të të dyja ministrive, unifikimin e edukimit dhe trajnimit ushtarak, trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së, trajnimin dhe bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë ushtarake, ndihmën financiare ushtarake dhe ndihmën financiare.

9 Në vitin 2011 MFSK-ja ka arritur Partneritetet Shtetëror me Gardën Kombëtare të Iowa-s, SHBA. Gjatë zbatimit të këtij programi, pjesëtarët e FSK-së, në njërën anë, kanë marrë pjesë në ushtrimet në terren në Iowa dhe kanë shkëmbyer përvojat me Gardën Kombëtare të Iowa-s, kurse pjesëtarët e kësaj të fundit, në anën tjetër, kanë dhënë këshilla për FSK-në.

10 Në shkurt të vitit 2012 zyrtarë të lartë të Qeverisë së Kosovës dhe të Qeverisë së SHBA-së kanë nënshkruar marrëveshjen e SOFA-s në mes të Kosovës dhe SHBA-së, korniza juridike e së cilës mundëson që personeli civil i ushtrisë amerikane dhe i Departamentit të Mbrojtjes së SHBA-së, që nuk janë pjesë e misionit të NATO-s, do të operojnë në territorin e Kosovës. Sipas MPJ-së së Kosovës, personeli i SHBA-së do të punojë me pjesëtarët e FSK-së për të zhvilluar më shumë kapacitetet e kësaj të fundit në kryerjen e katër misionëve thelbësorë për Zjarrfikjen, Kërkimin dhe Shpëtimin, Largimin e Materieve të Rrezikshme dhe Largimin e Mjeteve Eksplozive (MPJ, 2012). Kurse, në korrik të vitit 2013, MFSK-ja dhe MM-ja e Shqipërisë kanë nënshkruar memorandum për SOFA. Ky memorandum rregullon hyrjen, daljen, vendosjen e përkohshme dhe statusin e pjesëtarëve të Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe të FSK-së në territoret e vendeve përkatëse (MFSK, 2013, f. 3).



gjithsejtë njëmbëdhjetë vende (9 prej të cilave janë vende anëtare të NATO-s dhe dy të tjera nuk janë anëtare të NATO-s).

Me gjithë bllokimin e Kosovës në raport me integrimin në NATO, Kosova ka arritur së paku të pranohet dhe të përfaqësohet pjesërisht në njërin prej organeve që ka të bëjë me NATO-n. Prej majit të vitit 2014, Kuvendi i Kosovës zyrtarisht është pranuar si vëzhgues në Asambleenë Parlamentare (AP) të NATO-s (NATO Parliamentary Assembly, 2014a). Dy deputetë të Kuvendit të Kosovës mund të marrin pjesë në kapacitetin e vëzhguesve në mbledhjet e AP-së së NATO-s. Kjo, megjithatë, nuk nënkupton se Kosova ka shënuar ndonjë përparim lidhur me anëtarësimin e mundshëm në NATO. AP-ja e NATO-s është e ndarë institucionalisht prej strukturës së NATO-s, funksionon në mënyrë të pavarur nga NATO-ja (NATO Parliamentary Assembly, 2013) dhe nuk është e lidhur me këtë të fundit sa i përket procesit të integritimeve euro-atlantike. Sipas Rregullores së Punës së AP të NATO-s, Kosova si vëzhgues mund t'i ndjekë mbledhjet e AP-së së NATO-s pasi të ftohet nga kryetari i saj dhe pas dhënies së pëlqimit nga ana e Komisionit të Përhershëm, i cili është organi kryesor vendimmarrës dhe më pas duhet të jepet miratimi edhe nga ana e Asamblesë. Për më shumë, përfaqësuesit e Kosovës mund të marrin pjesë në takimet e komisioneve të AP-së së NATO-s dhe kanë të drejtë të flasin, por nuk kanë të drejtë vote apo të kërkojnë ndryshime (NATO Parliamentary Assembly, 2014b, f. 4).

Kosova e ka vënë në krye të agjendës anëtarësimin në nismat rajonale të sigurisë duke besuar që anëtarësimi në këto nisma do ta bëjë më të lehtë më pas rrugën e anëtarësimit në PpP dhe në NATO (Kraja, 2014). Kjo mendohet të jetë kështu për shkak se strategji të ngjashme kishin përvetësuar Shqipëria dhe Kroacia në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në NATO, në vitin 2009. Prej tetorit të vitit 2014, Kosova është anëtare e Qendrës për Asistim në Zbatim dhe Verifikim të Kontrollit Rajonal të Armëve (RACVIAC) – Qendra për Bashkëpunim në Siguri. Megjithatë, Kosova nuk është pranuar me të drejta të plota në RACVIAC. Përkundër asaj se Kosova në nivel politik përfaqësohet në mënyrë të barabartë në të gjitha aktivitetet e RACVIAC-ut, megjithatë FSK-ja dhe përfaqësuesit e saj nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në takimet e RACVIAC-ut për shkak të kundërshtimit nga ana e Serbisë (RACVIAC, 2014b). Aktivitetet e kësaj nisme përfshijnë një gamë të gjerë të çështjeve politike-ushtarake, duke përfshirë reformën në sektorin e sigurisë dhe bashkëpunimin rajonal e ndërkombëtar, me theks të veçantë në integritet euro-atlantike (RACVIAC, 2014a). Meqenëse është anëtare e kësaj organizate, Kosova do të jetë në gjendje të përmbushë kushtet e anëtarësimit në NATO dhe të kontribuojë për fuqizimin e stabilitetit rajonal (Emini, 2014, f. 17). Një nismë tjetër e rëndësishme është Karta e Adriatikut (AC) në të cilën Kosova ka bërë kërkesë për anëtarësim në vitin 2012, por nuk ka pasur sukses të anëtarësohet. Pasi është bërë anëtare e RACVIAC-ut, autoritetet e Kosovës presin që vendi së shpejti të pranohet në AC. Kosova merr pjesë në konferencat, aktivitetet dhe ngjarjet e AC-së në kapacitetin e vëzhguesit; sidoqoftë, anëtarësimi në këtë nismë kundërshtohet fuqishëm nga Bosnja dhe Hercegovina (BH) (Koha Net, 2014b). AC-ja është një nismë e SHBA-së<sup>11</sup> për të

11 AC-ja promovon stabilitetin dhe integrimin euro-atlantik për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor duke i dhënë përkrahje bashkëpunimit në fushën politike, të mbrojtjes dhe atë ekonomike ndërmjet partnerëve dhe vendeve fqinje. Qëllimi i SHBA-së është të vazhdojë të ndihmojë këto vende në zbatimin e reformave të domosdoshme në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në NATO për të fuqizuar institucionet demokratike, shoqërinë civile, sundimin e ligjit, ekonominë e tregut dhe që ushtritë e këtyre vendeve të jenë në të njëjtën vijë me standardet e NATO-s (U.S. Department of State, 2011).

ndihmuar, mbështetur dhe përgatitur vendet e Ballkanit Perëndimor për t'ju bashkuar NATO-s (Çeku, 2014).

### 2.3. Forcat e Armatosura të Kosovës kundrejt NATO-s

Pas përvjetorit të gjashtë të pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2014, ish-kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, paralajmëroi themelimin e FAK-ut (ZKMK, 2014). Ky paralajmërim që u bë disa muaj para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2014 ishte pritur me befasi nga disa prej vendeve mike të Kosovës në NATO. Një diplomat i njëjës prej ambasadave të huaja në Kosovë ka nënvizuar se kjo ishte disi e papritur, meqë paralajmërimi erdhi pak para zhvillimit të zgjedhjeve. Megjithatë, sipas tij, kalimi i FSK-së në FAK varet prej Kosovës, por në rast se kjo ndodh, atëherë duhet të bëhen ndryshime kushtetuese të Kosovës dhe për këtë duhen votat e dy të tretave të shumicës së dyfishtë në Kuvendin e Kosovës. Kjo nënkupton që dy të tretat e votave të bashkësive etnike në Kosovë, shumicën e të cilave e mban bashkësia serbe në Kosovë, duhet të japin pëlqimin e tyre për një gjë të tillë. Sidoqoftë, Kuvendi i Kosovës ende nuk e ka miratuar pakon legjislative që ka të bëjë me themelimin e FAK-ut.

Mbi të gjitha, forcat e armatosura moderne janë shtylla kryesore e sektorit bashkëkohor të mbrojtjes dhe si shtet sovran, por edhe gjykuar sipas ambientit të sigurisë, Kosova duhet ta ketë të drejtën të formojë FAK-un. Përveç detyrave të tjera, FAK-u do të zëvendësojë rolin e KFOR-it në Kosovë pasi që NATO-ja të vendosë për tërheqjen e trupave të veta nga vendi dhe në këtë mënyrë FAK-u do të ngarkohet me përgjegjësi për garantimin e ambientit të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët në Kosovë. Asaj i duhet të forcojë më shumë elementët e mbrojtjes civile, duke përfshirë menaxhimin e krizave, gatishmërinë ndaj gjendjes së jashtëzakonshme, planifikimin emergjent, si edhe ofrimin e mbrojtjes ushtarake për autoritetet civile dhe të përballet me katastrofat që vijnë prej sulmeve terroriste.

Duke u bazuar në RSSS-në, FAK-u do të jetë forcë kombëtare ushtarake që pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Kosovës, rekruton qytetarë të Kosovës dhe do të jetë e pajisur për të përmbushur misionin e mbrojtjes, e autorizuar që të shërbejë në vend dhe jashtë vendit në mbështetje të operacioneve paqësore. FAK-u do të përbëhet prej gjithsejtë 5,000 pjesëtarëve aktivë dhe prej 3,000 pjesëtarëve rezervë (Kastrati, 2014), ndërsa do të ketë përgjegjësi për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës. Sipas Qeverisë së Kosovës, FAK-u do të ndërtohet sipas standardeve të NATO-s për ndërveprim. Për më shumë, FAK-u do ta ketë synim të qartë mundësinë e pjesëmarrjes në operacione ndërkombëtare si pjesë e strategjisë kombëtare për të ndërtuar raporte më të ngushta me NATO-n dhe përfundimisht anëtarësimin e Kosovës në NATO (Qeveria e Kosovës, 2014, fq. 31-32). Gjithashtu, është paraparë që MFSK-ja të riemërohet në MM të Kosovës me qëllim që të ushtrojë mbikëqyrje civile mbi FAK-un dhe të udhëheqë atë. Madje, MM-ja duhet të formulojë, zbatojë dhe zhvillojë politikat e mbrojtjes së Kosovës.

Shndërrimi i MFSK-së në MM dhe i FSK-së në FAK, sipas zyrtarëve të lartë të MFSK-së, po bëhet në bashkëpunim të plotë me Qeverinë e SHBA-së, më konkretisht me Nismën për Reformën e Institucioneve të Mbrojtjes, Gardën Kombëtare të Iowa-s, Ambasadën e SHBA-së në Prishtinë dhe me dy ekipet e NATO-s në Kosovë, EKN-në dhe ENKN-në. Gjithashtu, MFSK-ja ka hartuar Ligjin për Transformimin e FSK-së në FAK; sidoqoftë, ky i fundit nuk është miratuar nga Kuvendi i Kosovës,



meqë themelimi i FAK-ut kërkon amendamentimin e Kushtetutës së Kosovës. Përpos ligjit, ministri Demolli ka deklaruar se janë edhe gjashtëmbëdhjetë amendamente kushtetuese që priten të miratohen nga dy të tretat e shumicës së dyfishtë në Kuvendin e Kosovës, duke përfshirë edhe dy të tretat e bashkësive të pakicave në Kuvend. Në anën tjetër, duke e ditur që procesi i krijimit të FAK-ut varet prej zhvillimeve politike, ministri Demolli ka shprehur pikëpamjen që institucionet e Kosovës nuk kanë ndonjë afat kohor se kur do të votohet për pakon përkatëse legjislative dhe kushtetuese (Kuvendi i Kosovës, 2015, f. 3).

Megjithatë, për themelimin e FAK-ut nuk është diskutuar në strukturat e NATO-s dhe zyrtarisht as nuk është kundërshtuar e as mbështetur nga NATO-ja, ndonëse zyrtarë të lartë të Qeverisë së Kosovës kanë theksuar se NATO-ja e mbështet FAK-un (Kastrati, 2014). Në anën tjetër, zyrtarë të lartë të NATO-s kanë vënë në dukje se krijimi i FAK-ut është një “çështje e brendshme” e institucioneve të Kosovës. Gjatë vizitës së tij në Kosovë në janar të vitit 2015, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg ka konstatuar se “porosia kryesore është se NATO-ja nuk do të diktojë, NATO-ja nuk do të vendosë” për krijimin e FAK-ut (NATO, 2015a). Ai pati shtuar se NATO-ja është vetëm duke përmbushur misionin e vet në Kosovë në pajtim me mandatin që ia ka ngarkuar OKB-ja prej vitit 1999 dhe është duke mbështetur Kosovën në ndërtimin e kapaciteteve të FSK-së në kuadër të mandatit të saj. Sipas sekretarit Stoltenberg, çfarëdo që vendosin institucionet e Kosovës për FAK-un, kjo duhet të bëhet në atë mënyrë që nuk krijon tensione të reja; nuk kontribuon në rrezikim të stabilitetit; dhe të mos ketë hapa mbrapa për sa i përket kultivimit të dialogut ndërmjet të gjitha grupeve të ndryshme etnike për më shumë pajtim në shoqërinë e Kosovës. Ai madje pati nënvizuar se varet prej institucioneve të Kosovës të vendosin për FAK-un, ndërsa kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, ka dhënë zotimin se Kosova do të marrë pëlqimin e të gjitha subjekteve politike, duke i përfshirë edhe ato të bashkësisë serbe në Kosovë, për themelimin e FAK-ut (ZKMK, 2015).

Formimi i FAK-ut përkrahet fuqishëm nga vendet anëtare mike të Kosovës në NATO. Zyrtarë të lartë të Qeverisë së SHBA-së kanë dhënë mbështetjen për institucionet e Kosovës lidhur me përfundimin e procesit të shndërrimit të FSK-së në FAK. Sipas një komunikate të MPJ-së, Zëvendës Ndihmëssekretarja amerikane e Mbrojtjes për Rusi/Ukrainë/Euroazi, Evelyn N. Farkas, gjatë një takimi në Pentagon me përfaqësues të Qeverisë së Kosovës, ka theksuar se Kosova do të gëzojë përkrahjen e SHBA-së në fushën e sigurisë (MPJ, 2015). Madje, nga ky takim ishte theksuar se hapat drejt themelimit të FAK-ut do ta bëjnë më të sigurt rrugën e saj drejt anëtarësimit në PpP dhe në NATO.

## 2.4. Perceptimi publik në Kosovë për integrim në NATO dhe krahasimi me vendet e rajonit

Edhe pse NATO-ja nuk e njeh Kosovën dhe, për më shumë, nuk ka asnjë marrëdhënie zyrtare me Kosovën, ajo gëzon shkallë të lartë të besimit dhe të besueshmërisë në mesin e qytetarëve të Kosovës. Për sa i përket integritimeve euro-atlantike të Kosovës, qytetarët e saj mbështesin vizionin që vendi t'i bashkohet NATO-s, sikundër që mbështesin edhe punën e pranisë së saj ndërkombëtare në Kosovë (KFOR-in) në ofrimin e sigurisë për të gjithë qytetarët.




Figura 1: Perceptimi publik në Kosovë për anëtarësim në NATO<sup>12</sup>


Hulumtimi i opinionit publik i Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS) i kryer nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) gjatë muajit tetor të vitit 2014, tregon se shumica e gjerë e të anketuarve (88.7 për qind) mendojnë se vendi duhet të bëhet anëtar i NATO-s. Sipas rezultateve të BKS-së, 8.7 për qind e të anketuarve kanë qenë kundër anëtarësimit në NATO, kurse 2.6 për qind prej tyre nuk e dinë ose nuk kanë mendim lidhur me anëtarësimin e Kosovës në NATO.

Në anën tjetër, serbët e Kosovës kanë një mendim krejtësisht të ndryshëm lidhur me pyetjen nëse Kosova duhet të bëhet anëtare e NATO-s; që këtë shumica prej tyre kanë dhënë përgjigje negative kur janë pyetur për këtë çështje. Në krahasim me shumicën e popullsisë shqiptare të Kosovës dhe të tjerët, 76 për qind e serbëve të Kosovës të anketuar kundërshtojnë në mënyrë të vendosur integrimin e Kosovës në NATO; vetëm 8 për qind e tyre mbështesin integrimin, kurse 16 për qind e serbëve të anketuar nuk kanë mendim nëse Kosova duhet t'i bashkohet NATO-s. Refuzimi i bashkësisë serbe ndaj integrimit të Kosovës në NATO mund të shpjegohet si shkak i intervenimit humanitar të NATO-s dhe sulmeve të saja ajrore kundër Serbisë me qëllim të ndalimit të spastrimit etnik në Kosovë gjatë vitit 1999.

Përkundër shkallës së lartë të përkrahjes së dëshmuar prej qytetarëve të Kosovës (me përjashtim të serbëve të Kosovës) dhe prej udhëheqësve institucionalë, sfidat e lartpërmendura politike po e mbajnë peng Kosovën nga hyrja në procesin e integritimeve euro-atlantike. Sidoqoftë, mund të argumentohet që mbështetja për NATO-n, gjë që është dëshmuar vazhdimisht prej qytetarëve të Kosovës, ka të bëjë me dy arsye. Së pari, prania ndërkombëtare e NATO-s ka dhënë kontribut të rëndësishëm drejt përmirësimit të situatës së sigurisë në Kosovë, me përjashtim të veriut të Kosovës, dhe në ndërtimin e besimit në mes të të gjitha bashkësive në Kosovë. Arsyeja e dytë i atribuohet synimeve të Kosovës për anëtarësim në NATO, gjë që përmendet në mënyrë të qartë në pothuajse çdo dokument zyrtar shtetëror krahas integrimit në BE. Si i tillë dhe në vijim të diskursit

12 (Kosovar Center for Security Studies, 2014).

politik në Kosovë, integrimi euro-atlantik shihet si një prej qëllimeve kryesore afatmesme dhe afatgjata (Vrajolli & Kallaba, 2012, f. 12).



**Figura 2: Perceptimi publik në Kosovë në krahasim me Malin e Zi, Maqedoninë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën për anëtarësim në NATO<sup>13</sup>**

Pikëpamjet e qytetarëve të Kosovës për anëtarësim në NATO dallojnë në krahasim me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor që njëjtë si Kosova synojnë integrimin. Për shembull, në Mal të Zi perceptimi publik për integrim në NATO është relativisht i ulët. Sipas sondazhit të Qendrës për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut në vitin 2014, 45 për qind e të anketuarve do të votonin kundër anëtarësimit në NATO. Anëtarësimi i Malit të Zi në NATO përkrahet vetëm prej 35 për qind të qytetarëve dhe 20 për qind prej tyre janë të pavendosur ose nuk kanë mendim lidhur me integrimet euro-atlantike. Megjithatë, Mali i Zi iu ka bashkuar programit të PpP-së në vitin 2006 dhe prej vitit 2009 e ka marrë Planin e Veprimit për Anëtarësim (PVA). PVA-ja është faza e fundit për një vend që synon integrimin në mënyrë që të përgatitet për anëtarësimin dhe të dëshmojë aftësinë për t'i plotësuar obligimet dhe zotimet e anëtarësimit të mundshëm në të ardhmen (NATO, 2014h). Pavarësisht mbështetjes së ulët për anëtarësimin në NATO nga malazezët, në krahasim me qytetarët e Kosovës, megjithatë NATO-ja ka bashkëpunim e marrëdhënie zyrtare me Malin e Zi, kurse në fund të vitit 2015 NATO-ja do të bëjë vlerësimin për ta ftuar ose jo këtë vend për t'u anëtarësuar në organizatë (NATO, 2014f).

Opinionit publik në Maqedoni kryesisht e mbështet anëtarësimin në NATO. Sondazhi i opinionit publik i vitit 2014 që ishte realizuar nga Instituti Ndërkombëtar Republikan ka treguar se qytetarët e Maqedonisë ndajnë mendim të ngjashëm me qytetarët e Kosovës, ndonëse me disa dallime shpërfillëse në përqindje kur krahasohet me Kosovën. Prandaj, 77 për qind prej tyre e përkrahin anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, 15 për qind ishin shprehur kundër integritit në NATO, kurse 7 për qind nuk kanë ndonjë mendim. Megjithatë, ka dallime të mëdha ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë për sa i përket përparimit të të dyja vendeve drejt anëtarësimit në NATO. Në vitin 1995,

13 (Kosovar Center for Security Studies, 2014); (Centre for Democracy and Human Rights, 2014, f. 9); (International Republican Institute, 2014, f. 13); (Foreign Policy Initiative BH, 2012, f. 58).

Maqedonia iu bashkua programit të PpP-së dhe në vitin 1999 i ishte dhënë PVA-ja, por anëtarësimi i Maqedonisë në NATO ka mbetur peng prej kohës kur Greqia ka bllokuar Maqedoninë që t'i bashkohet NATO-s gjatë Samitit të Bukureshtit më 2009 për shkak të mosmarrëveshjeve ndërmjet këtyre dy vendeve lidhur me emrin zyrtar të Maqedonisë (Lungescu, 2008). Ndërsa, qëndrimi i NATO-s është se Maqedonia do të ftohet për t'ju bashkuar NATO-s pasi të arrijë një marrëveshje me Greqinë që do të ishte e pranueshme për të dyja palët (NATO, 2014j). Është e rëndësishme të përmendet se për qytetarët e Maqedonisë më i rëndësishëm është emri i vendit sesa anëtarësimi në NATO. Në mesin e shumë çështjeve të tjera, 6 për qind e të anketuarve ishin përgjigjur se problemi më serioz është emri i vendit, kurse 3 për qind prej tyre ishin përgjigjur se integrimi në NATO është problemi më serioz (International Republican Institute, 2014, f. 4).

Ngjashëm si Maqedonia, shumica e qytetarëve të BH-së përkrahin integrimin në NATO. Në bazë të një hulumtimi të opinionit që ishte bërë në vitin 2012 nga Foreign Policy Initiative BH, shumica e të anketuarve, pra 66 për qind e tyre, ishin në përkrahje të anëtarësimit të BH-së në NATO, 26 për qind ishin kundër dhe 8 për qind ishin shprehur të pavendosur për këtë çështje. Megjithatë, si me rastin e serbëve të Kosovës, edhe serbët që jetojnë në Republikën Serbe në BH kundërshtojnë integrimin e vendit në NATO. Prandaj, 52 për qind prej tyre nuk e përkrahin anëtarësimin e BH-së në NATO, 37 për qind ishin përgjigjur se BH-ja duhet të bëhet anëtare e NATO-s dhe 10 për qind e të anketuarve ishin të pavendosur (Foreign Policy Initiative BH, 2012, f. 58). Njëjtë si me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, Kosova dhe BH-ja dallojnë shumë prej njëra tjetrës për sa i përket rrugës së integritit të tyre në NATO. BH-ja iu bashkua PpP-së në vitin 2006, pas dy viteve hyri në Dialogun e Intensifikuar me NATO-n dhe në vitin 2010, NATO-ja e ftoi BH-në t'i bashkohet PVA-së, por me kusht që së pari të plotësohet kushti për regjistrimin e pronave të lëvizshme në fushën e mbrojtjes (NATO, 2014i).

Prandaj, si përfundim mund të nxirret se integrimi në NATO nuk është i ndërlidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me përkrahjen publike të qytetarëve për këtë proces. Përkundrazi, kjo dëshmon se procesi i gjatë i integritit në NATO është më shumë proces politik që pasohet me përmbushjen e kushteve të caktuara prej vendeve që synojnë të anëtarësohen në NATO. Megjithatë, nëse procesi i integritit të Kosovës në NATO zgjatet pafundësisht, ekziston rreziku që perceptimi i qytetarëve të Kosovës ndaj integritit në NATO mund të ndryshojë, përkatësisht mund të zbritet përkrahja e qytetarëve për anëtarësimin e Kosovës në NATO. Shkalla e lartë e mbështetjes nga qytetarët e Kosovës për integrim në NATO, që është dëshmuar në vazhdimësi, nuk mund të garantohet edhe më tej në planin afatgjatë përderisa Kosova ka mbetur jashtë procesit të zgjerimit. Duke e ditur këtë, NATO-ja duhet të rishikojë marrëdhëniet e saj me Kosovën dhe të lëvizë përpara drejt vendosjes së marrëdhënieve kontraktuale me institucionet e Kosovës.

## SEKSIONI 3 – Politikat alternative për marrëdhëniet e ardhshme Kosovë-NATO

Ky hulumtim ka gjetur se anëtarësimi i Kosovës në NATO sfidohet nga pengesa të brendshme dhe të jashtme. Prandaj, QKSS-ja synon të ofrojë zgjidhje, propozime dhe alternativa se si të ecë Kosova përpara në këtë drejtim. Politikat alternative mendohet të shërbejnë si rekomandime për institucionet e Kosovës për të filluar bashkëpunimin me NATO-n dhe të hyhet në marrëdhënie kontraktuale me NATO-n, gjë që do të çonte në drejtim të hapjes së procesit të integritimit dhe anëtarësimit me të drejta të plota. Pamundësia e institucioneve të Kosovës për t'u ballafaquar me integritimin në NATO dhe pengesat politike të shkaktuara nga mosnjohja e Kosovës prej katër vende anëtare të NATO-s paraqesin dy sfidat kyçe, të cilave duhet t'ju qasen institucionet e Kosovës më me ngulm. Për më shumë, pasi që Kosova të arrijë marrëdhëniet kontraktuale me NATO-n dhe pasi të bëjë kërkesë për anëtarësim në të, asaj do t'i duhet ti përmbushë kushtet e anëtarësimit në NATO. Këto kushte janë: (i) funksionimi i sistemit të demokracisë politike sipas ekonomisë së tregut; (ii) trajtimi i barabartë i pakicave; (iii) zotimi për zgjidhjen paqësore të konflikteve; (iv) aftësia dhe vullneti për të dhënë kontribut ushtarak në operacionet e NATO-s; dhe (v) zotimi për demokratizimin e marrëdhënieve civile-ushtarake dhe demokratizimin e strukturave institucionale (NATO, 2014h). Pavarësisht pengesave politike të cilat e kanë bllokuar Kosovën të vendosë marrëdhëniet kontraktuale me NATO-n, megjithatë Kosova është në proces të përmbushjes së këtyre kushteve.

Alternativat në vijim ofrojnë zgjidhjet se si të shkohet përpara në përmirësimin e marrëdhënieve Kosovë-NATO me qëllim që t'i shërbejnë institucioneve të Kosovës në ndërtimin e politikave të reja për të nisur zyrtarisht procedurat e anëtarësimit në PpP dhe në NATO.

### 3.1. Skenari i parë: Nga dialogu Kosovë-NATO deri te anëtarësimi me të drejta të plota


Në vijim të idesë së ministrit të Punëve të Jashtme të Letonisë, i cili për herë të parë përmendi se dialogu i strukturuar dhe zyrtar ndërmjet Kosovës dhe NATO-s është i mundshëm dhe mund të zhvillohet më tej në mes të të dyja palëve, institucionet e Kosovës duhet të reflektojnë dhe të marrin parasysh atë. Ato duhet të kërkojnë në mënyrë të qartë nga KVA-ja e NATO-s të nisë dialogun zyrtar me Kosovën. Ky dialog duhet të jetë i kufizuar saktësisht sipas afateve kohore, pra nuk duhet të zgjasë më shumë se dy vite dhe qëllim kryesor duhet të ketë përgatitjen e Kosovë që të marrë pjesë e të fitojë anëtarësimin në PpP dhe rrjedhimisht në NATO. Në tetor të vitit 2014, atëherë ministri në detyrë i FSK-së, Agim Çeku, pati zbuluar hollësitë se si mund të zhvillohet ky dialog; një dialog që do të çonte drejt vendosjes së marrëdhënieve zyrtare ndërmjet Kosovës dhe NATO-s. Pas themelimit të FAK-ut dhe miratimit të pakos së ligjeve nga Kuvendi i Kosovës, sipas Çekut, Grupi Punues për NATO-n (GPN) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës (ZKMK) do të jetë përgjegjës për përgatitjen e një plani të quajtur Dokumenti i Prezantimit (Çeku, 2014). Pas kësaj, Qeveria e Kosovës, më saktësisht MPJ-ja e Kosovës, do të duhej të dorëzonte këtë dokument tek autoritetet e NATO-s me kërkesë kryesore që të hapet zyrtarisht dialogu Kosovë-NATO.

Dialogu duhet të fillojë me arritjen e një marrëveshjeje ose zgjidhjeje të pranueshme për të dyja palët, Kosovën dhe NATO-n, për rolin e KFOR-it në Kosovë dhe vlerësimin e këtij misioni në terren. Kjo marrëveshje duhet të përfshijë zvogëlimin e numrit të trupave të KFOR-it dhe në mënyrë graduale të bëhet bartja e përgjegjësisë nga KFOR-i tek FAK-u dhe PK-ja, veçanërisht përgjegjësitë që kanë të bëjnë me Manastirin e Deçanit dhe për vijat kufitare të Kosovës me Serbinë në pjesën veriore dhe lindore të vendit. Dialogu zyrtar dhe i strukturuar Kosovë-NATO duhet të bëjë një vlerësim gjithëpërfshirës për misionin e KFOR-it në Kosovë, përkatësisht kjo duhet të bëhet nga NATO-ja në bashkëpunim me institucionet e Kosovës. Përgjegjësia kryesore e KFOR-it për garantimin e ambientit të qetë dhe të sigurt në Kosovë duhet t'i bartet gradualisht FAK-ut në pajtim me përparimin që do të shënojë Kosova në procesin e integritetit në NATO. Përveç kësaj, FAK-u duhet të punojnë ngushtë me KFOR-in për të marrë gradualisht përgjegjësitë nga KFOR-i. Duke e ditur që mandati i KFOR-it buron nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit, e cila ende nuk është shfuqizuar, atëherë menjëherë pas themelimit, FAK-u duhet të zhvillojnë kapacitetet njerëzore dhe operative që tërthorazi do ta bënin rolin e KFOR-it në Kosovë të panevojshme para shteteve anëtare të NATO-s. Si pasojë e kësaj, rëndësia e FAK-ut do të rritej dhe kjo do të çonte deri tek marrja e përgjegjësisë nga KFOR-i për të garantuar një ambient të qetë dhe të sigurt në vend. Gjithashtu, kjo do t'i hapë rrugën institucioneve të Kosovës të nisin zyrtarisht procesin e anëtarësimit në NATO. Mirëpo, para tërheqjes së KFOR-it, duhet të bëhet përcaktimi, përkatësisht demarkacioni i kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë, qoftë nën ndërmjetësimin e BE-së, qoftë të NATO-s. Një marrëveshje e tillë, për të cilën QKSS-ja vlerëson se është e mundur, do të shpinte drejt paqes dhe stabilitetit afatgjatë në rajonin e Ballkanit Perëndimor që është hapi kryesor për normalizimin e marrëdhënieve dhe proceset integruese euro-atlantike për Kosovën dhe Serbinë.

Gjithashtu, është e nevojshme që NATO-ja e cila i ka dy misione kontributdhënëse në Kosovë, pra EKN-ja dhe ENKN-ja të shkrihet në një mision të vetëm, mundësisht në formën e Zyrës Ndërlidhëse të NATO-s në Kosovë (ZNNK). ZNNK-ja duhet të jetë e pavarur nga KFOR-i dhe përgjegjësia e saj kryesore duhet të përqendrohet në mbështetje të FSK-së apo të FAK-ut në të ardhmen, por në të njëjtën kohë nuk duhet të kufizohet vetëm në këtë përgjegjësi. Misioni i saj duhet të ketë dimension politik për të ndihmuar, mbështetur dhe përgatitur anëtarësimin e Kosovës në NATO. Përveç kësaj, ZNNK-ja duhet të këshillojë dhe ndihmojë institucionet e Kosovës në rrugën drejt anëtarësimit në NATO dhe për dallim prej mandatit të KFOR-it, ZNNK-ja do të qëndrojë në Kosovë derisa kjo e fundit të bëhet anëtare e NATO-s me të drejta të plota. Në anën tjetër, pas hapjes së dialogut zyrtar dhe të strukturuar me NATO-n, institucionet e Kosovës presin që NATO-ja të emërojë një Përfaqësues Special, i cili do të ketë mandat politik për përfaqësimin e NATO-s në Kosovë (Çeku, 2014). Përfaqësuesi Special i NATO-s në Kosovë (PSNK) duhet të punojë ngushtë, veçanërisht me MPJ-në e Kosovës lidhur me çështjet e dialogut zyrtar dhe të strukturuar në mes të Kosovës dhe NATO-s. Gjithashtu, PSNK-ja duhet të bashkëpunojë me ZNNK-në për të mbështetur Kosovën për anëtarësim në NATO dhe të marrë përsipër detyrën për bashkërendimin e të gjitha çështjeve që dalin nga marrëdhëniet Kosovë-NATO. Sipas zyrtarëve të lartë të Qeverisë së Kosovës, rivendosja e ZNNK-së dhe emërimi i PSNK-në në Kosovë ka mundësi të ndodhin gjatë vitit 2015; megjithatë, kjo nuk nënkupton që politikëbërësit e Kosovës duhet të presin se çfarë do të vendosë NATO-ja për këto çështje. Ata duhet të themelojnë GPN-në sa më shpejt që të jetë e mundur, si edhe të përgatisin dhe të dorëzojnë Dokumentin e Prezantimit në NATO dhe tek të gjitha vendet anëtare të NATO-s, që përfundimisht duhet të çojë tek hapja e dialogut zyrtar Kosovë-NATO.

Synimi final i këtij dialogu zyrtar në mes të Kosovës dhe NATO-s duhet të jetë nënshkrimi i një marrëveshje dypalëshe prej të dyja palëve; kjo do ta shpinte Kosovën përfundimisht në drejtim të hyrjes në dialog kontraktual me NATO-n. Marrëveshja duhet të bazohet në të njëjtin modalitet sikurse me atë që është përdoruar nga dialogu i lehtësuar nga BE-ja në mes të Kosovës e Serbisë, që nënkupton se VMN-të e NATO-s nuk do ta bllokojnë përparimin e Kosovës në dialog me NATO-n dhe NATO-ja do të angazhohet për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë. Madje, kjo marrëveshje duhet të mundësojë pjesëmarrjen e FAK-ut në operacionet e NATO-s dhe në misionet ndërkombëtare paqeruajtëse të NATO-s. Marrëveshja duhet të garantojë se Kosovës do t'i jepet PV-PI-ja, i cili si pjesë integrale përfshin elementin e Dialogut të Intensifikuar dhe në të cilin vendet që synojnë t'i bashkohen NATO-s ftohen të ndërmarrin dhe zbatojnë reformat përkatëse. Kjo marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe NATO-s duhet të sigurojë që të hapet procesi i anëtarësimit në PpP dhe në Këshillin e Partneritetit Euro-Atlantik me përmbushjen e kushteve të kërkuara për anëtarësim në këto programe që do të jenë përgjegjësi e institucioneve të Kosovës. Sidoqoftë, çfarëdo vendimi për anëtarësim në PpP do të varet nga dhënia e pëlqimit të të gjitha vendeve anëtare të NATO-s, duke e marrë parasysh që një vendim i tillë merret me konsensus. Përkundër kësaj, përfundimi i suksesshëm i dialogut zyrtar e të strukturuar dhe anëtarësimi i plotë i Kosovës në PpP do të jenë ato që përfundimisht do t'i hapin derën Kosovës për të marrë PVA-në si faza e fundit për plotësimin e obligimeve për anëtarësim në NATO.

**Nga dialogu Kosovë-NATO deri te anëtarësimi me të drejta të plota**



**Figura 3: Skenari i parë – Nga dialogu Kosovë-NATO deri te anëtarësimi me të drejta të plota**



### 3.2. Skenari i dytë: Bashkëpunimi dypalësh me vendet e NATO-s

33

Nëse skenari i parë dështon, institucionet e Kosovës duhet të përgatiten për një skenar tjetër që përqendrohet më shumë në thellimin e bashkëpunimit dypalësh me vendet anëtare të NATO-s. Përderisa Kosova është e bllokuar nga VMN-të e NATO-s dhe e parandalon atë të vendosë marrëdhënie kontraktuale me NATO-n, Kosova duhet të gjejë zgjidhje të tjera për t'ju qasur NATO-s përmes bashkëpunimit të ngushtë me vendet e NATO-s.

Institucionet e Kosovës, përkatësisht MFSK-ja ose MM-ja në të ardhmen, njëjtë siç ka vepruar më parë me disa vende të NATO-s, në bashkëpunim me MPJ-në e Kosovës, duhet të këmbëngulë në arritjen e marrëveshjeve dypalëshe me vendet e tjera të NATO-s, duke përfshirë Mbretërinë e Bashkuar, Francën, Italinë, Holandën, Belgjikën, Turqinë dhe vende të tjera anëtare të NATO-s. Marrëveshjet dypalëshe ekzistuese dhe ato që pritet të bëhen duhet të përqendrohen në programe të trajnimit dhe ushtrime të përbashkëta të FAK-ut me forcat e armatosura të këtyre vendeve përkatëse. Gjithashtu, FAK-u duhet të përgatitet sa i përket pjesëmarrjes në operacionet ndërkombëtare paqeruajtëse. Vendet anëtare mike të Kosovës në NATO mund të ndihmojnë në zhvillimin e kapaciteteve të FAK-ut në pajtim me standardet e NATO-s për ndërveprim. Në këtë vështrim, për institucionet e Kosovës është shumë e rëndësishme të ndjekin shembujt dhe rastet e suksesshme të atyre vendeve që më parë janë anëtarësuar në NATO. MPJ-ja e Kosovës dhe MFSK-ja ose apo MM-ja në të ardhmen duhet të nënshkruajnë marrëveshje dypalëshe me ministrinë përkatëse të Shqipërisë dhe Kroacisë në mënyrë që të përfitojnë nga rastet e këtyre vendeve gjatë anëtarësimit në PpP dhe në NATO. Përveç kësaj, institucionet e Kosovës duhet të kenë për detyrë të shikojnë dhe studiojnë PVA-të e Malit të Zi dhe Maqedonisë.

Pasi Kosova të arrijë marrëveshje dypalëshe me vende të NATO-s, do të jetë më e lehtë për institucionet e saj të pranojnë dhe përmbushin kushtet e anëtarësimit në NATO derisa të tejkalohen pengesat politike për integrim në NATO. Në mbështetje të kësaj, institucionet e Kosovës, në këtë rast FAK-u, mund të përmbushë njëanshëm kushtet dhe standardet e nevojshme për anëtarësim në NATO. Në këtë mënyrë, Kosova në njëfarë shkalle do të përgatitet kur të vijë deri tek kërkesa për anëtarësim në programin e PpP-së dhe në NATO. Në të njëjtën kohë, bashkëpunimi dypalësh duhet të garantojë se vendet anëtare mike të Kosovës në NATO do të mbështesin zbatimin dhe përmbushjen e njëanshme të standardeve të NATO-s nga ana e institucioneve të Kosovës. Ky skenar alternativ për anëtarësim në NATO është i rëndësishëm të merret parasysh përmes bashkëpunimit të të gjitha institucioneve, duke përfshirë Qeverinë, MPJ-në dhe MFSK-në ose MM-në në të ardhmen në të gjitha fazat, gjë që do të sillte bashkëpunim më të fuqishëm me vendet mike të NATO-s.

Qeveria e Kosovës, në mënyrë të veçantë, MFSK-ja ose MM-ja në të ardhmen dhe MPJ-ja, duhet të rrisin numrin e atasheve ushtarakë të Kosovës në misionet diplomatike të Kosovës tek vendet anëtare të NATO-s. Kjo do të thellonte më shumë marrëdhëniet në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe të diplomacisë me këto vende. Madje, MPJ-ja duhet të ketë parasysh idenë që të zgjerojë dhe të shtojë numrin e stafit diplomatik në vendet anëtare të NATO-s, me theks të veçantë në SHBA, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Turqi dhe vende të tjera. Ambasadat e Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me vendet mike të Kosovës në NATO duhet të kenë si qëllim të ndikojnë tek VMN-të e NATO-s që ato të zbusin qëndrimin e tyre për pavarësinë e Kosovës.

Duke sjellë ndër mend se ky skenar është më pak i leverdishëm sesa skenari i parë për sa i përket integritetit në NATO, megjithatë institucionet në Kosovë që janë përgjegjëse për integrim në NATO, duhet t'i shterin të gjitha mundësitë derisa vendi të marrë dritën e gjelbër për të hyrë në marrëdhënie kontraktuale me NATO-n.

## Bashkëpunimi dypalësh me vendet e NATO-s




Figura 4: Skenari i dytë – Bashkëpunimi dypalësh me vendet e NATO-s

## REKOMANDIME

### Për institucionet e Kosovës:

- Grupi Punues për NATO-n duhet të themelohet nga kryeministri i Kosovës. Politikëbërësit e Kosovës duhet të ndërmarrin reformat e nevojshme në mënyrë të menjëhershme për të vënë në praktikë synimin për të zhvilluar marrëdhëniet kontraktuale Kosovë-NATO, por edhe obligimet dhe hapat që duhet t'i ndjekin për anëtarësim në NATO (për më shumë hollësi, shih Tabelën 1).
- Diplomacia e Kosovës duhet të vihet në veprim dhe të bëhet më aktive duke punuar me vendet e saja mike në NATO, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Turqinë, Francën dhe vendet e tjera që të ndikojnë tek katër vendet mosnjohëse të NATO-s në mënyrë që të zbusin qëndrimin e tyre ndaj statusit të Kosovës.
- Institucionet e Kosovës duhet të kërkojnë nisjen e dialogut zyrtar me NATO-n që do të ishte i kufizuar në kohë dhe në njëfarë mënyre do ta përgatiste Kosovën për anëtarësim në programin e Partneritetit për Paqe dhe për hapat tjerë për anëtarësim në NATO (shih skenarin e parë).
- Institucionet e Kosovës duhet kërkojnë hapjen e Zyrës Ndërlidhëse të Kosovës në selinë e NATO-s në Bruksel, derisa Kosova zyrtarisht të ketë të drejtë të dërgojë zyrtarin e përhershëm ndërlidhës në selinë e NATO-s në kuadër të programit Partneriteti për Paqe dhe të themelojë Përfaqësinë e Përhershme në selinë e NATO-s.
- Zyrtarët e lartë të institucioneve të Kosovës duhet të kenë vizita dhe takime më të shpeshta në NATO me Sekretarin e Përgjithshëm të saj dhe me përfaqësuesit e vendeve anëtare të NATO-s;
- Kosova duhet të thellojë dhe fuqizojë bashkëpunimin dypalësh me vendet anëtare të NATO-s përmes këtyre veprimeve:
  - Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës ose Ministria e Mbrojtjes në të ardhmen duhet të arrijnë marrëveshje dypalëshe me vendet e NATO-s, veçanërisht me ato vende që ende nuk kanë ndonjë marrëveshje, siç janë Mbretëria e Bashkuar, Franca, Italia, Holanda, Belgjika dhe vende të tjera. Përveç kësaj, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zbatimit të marrëveshjeve ekzistuese. Ato mund të jenë shumë të dobishme dhe Kosova mund të përfitojë prej tyre gjatë rrugës drejt NATO-s.
  - Përmes bashkëpunimit dypalësh me këto vende, Kosova duhet të nisë zbatimin dhe përm-bushjen e njëanshme të kushteve dhe standardeve të nevojshme për integrim në Partneritetin për Paqe dhe në NATO.
  - Për të fuqizuar marrëdhëniet me vendet e NATO-s në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe mbështetjes për Kosovën drejt integritetit në NATO, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës ose Ministria e Mbrojtjes në të ardhmen dhe Ministria e Punëve të Jashtme duhet të rrisin numrin e atasheve ushtarakë në misionet diplomatike të Kosovës tek vendet mike në NATO.

- Ministria e Punëve të Jashtme duhet të marrë parasysh mundësinë e rritjes së numrit të stafit diplomatik të Kosovës në vendet anëtare të NATO-s, veçanërisht në ambasadat e Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Turqi dhe vende të tjera.
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës ose Ministria e Mbrojtjes në të ardhmen duhet të nënshkruajnë marrëveshje dypalëshe me ministrinë përkatëse të Shqipërisë dhe Kroacisë për të përfituar nga shembujt e tyre sa i përket integritetit në Partneritetin për Paqe dhe në NATO. Kosova duhet të ndjekë dhe të mësojë prej suksesit të këtyre vendeve drejt anëtarësimit në NATO.
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës ose Ministria e Mbrojtjes në të ardhmen, si edhe Grupi Punues për NATO-n dhe Departamenti për NATO dhe Politika të Sigurisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme duhet të ngarkohen me detyrën për të shikuar dhe studiuar Planin e Veprimit për Anëtarësim të Malit të Zi dhe Maqedonisë për t'u përgatitur kur të vijë deri te kërkesa zyrtare për anëtarësim në NATO.
- Kosova dhe institucionet e saj duhet të fillojnë bashkëpunimin me vendet mos-njohëse të NATO-s përmes dialogu të intensifikuar në takime shumëpalëshe në nivel rajonal që do të shënonte fazën fillestare të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe këtyre vendeve.
- Ministria e Punëve të Jashtme duhet të kërkojë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet tjera të Ballkanit Perëndimor që të mos bllokohet njohja dhe anëtarësimi i Kosovës me të drejta të plota në Kartën e Adriatikut.
- Anëtarësimi i Kosovës në NATO nuk është çështje e afateve kohore. Politikanët e Kosovës nuk duhet të japin premtime boshe se kur mund të anëtarësohet vendi në NATO. Integrimi në NATO nuk varet vetëm nga institucionet e Kosovës, por varet edhe prej vendimeve që merren me konsensus brenda NATO-s dhe në mesin e vendeve anëtare të kësaj të fundit.

### **Për Forcat e ardhshme të Armatosura të Kosovës:**

- Si ushtria e ardhshme e Kosovës, Forcat e Armatosura të Kosovës duhet të marrin përgjegjësitë në fushën e sigurisë sa i përket mbrojtjes së integritetit territorial dhe sovranitetit të Kosovës.
- Në arritjen e kapaciteteve për të qenë përgjegjëse për ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë për qytetarët dhe territorin e Kosovës, Forcat e Armatosura të Kosovës duhet të jenë të gatshme për të marrë detyrat nga KFOR-i duke e ditur që kjo e fundit nuk do të qëndrojë në Kosovë pafundësisht.
- Forcat e Armatosura të Kosovës duhet të trajnohen profesionalisht për të qenë të gatshme të marrin pjesë në operacionet ndërkombëtare paqeruajtëse. Institucionet e përfshira për Forcat e Armatosura të Kosovës duhet të ndërmarrin reformat e nevojshme në politikën e mbrojtjes sipas kushteve të NATO-s për ngritjen e forcave moderne të armatosura. Për arritjen e këtij qëllimi, institucionet e vendit duhet të punojnë me NATO-n për ndërveprimin e Forcave të Armatosura të Kosovës.

## Për NATO-n dhe vendet mike të Kosovës në NATO:

- Katër vendet e NATO-s: Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja - duhet të njohin Kosovën sa më parë. Ato nuk kanë arsye adekuate në qëndrimin e tyre për të mos e njohur Kosovën, meqë rasti i pavarësisë së Kosovës është unik, i veçantë dhe rrjedhimisht nuk mund të shërbejë si rast për vendet tjera për shpallje të pavarësisë. Madje, duke marrë vendimin për njohjen e Kosovës, këto vende do të kontribuonin për paqen dhe stabilitetin afatgjatë në Ballkanin Perëndimor dhe përfundimisht do t'i hapnin rrugën Kosovës drejt integritetit në NATO.
- Vendet mike të Kosovës në NATO duhet të mbështesin Kosovën përmes ndikimi tek katër vendet mos-njohëse për të ndryshuar qëndrimin e tyre lidhur me pavarësinë e Kosovës.
- NATO duhet të marrë parasysh hapjen e dialogut zyrtar dhe të strukturuar ndërmjet Kosovës dhe NATO-s (shih skenarin e parë). Strukturat vendimmarrëse të NATO-s duhet të marrin vendim për:
  - Nisjen e dialogut në mes të Kosovës dhe NATO-s që do të shpinte Kosovën në drejtim të anëtarësimit në Partneritetin për Paqe dhe në NATO.
  - Bashkimin e dy misionëve të NATO-s në Kosovë në Zyrë Ndërlidhëse të NATO-s në Kosovë dhe të emërohet Përfaqësuesi Special i NATO-s në Kosovë që do të ketë për mision udhëheqjen e dialogut zyrtar dhe të strukturuar me institucionet e Kosovës.
- NATO-ja në bashkëpunim me institucionet e Kosovës duhet të bëjë vlerësimin e misionit të KFOR-it në Kosovë. Përgjegjësia kryesore e KFOR-it për garantimin e ambientit të qetë dhe të sigurt në Kosovë duhet t'i bartet gradualisht Forcave të Armatosura të Kosovës në pajtim me përparimin që do të shënojë Kosova në procesin e integritetit në NATO. Përveç kësaj, Forcat e Armatosura të Kosovës duhet të punojnë ngushtë me KFOR-in për të marrë gradualisht përgjegjësitë nga KFOR-i. Duke e ditur që mandati i KFOR-it buron nga Rezoluta 1244 e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, e cila ende nuk është shfuqizuar, atëherë menjëherë pas themelimit, Forcat e Armatosura të Kosovës duhet të zhvillojnë kapacitetet njerëzore dhe operative që tërthorazi do ta bënin rolin e KFOR-it në Kosovë të panevojshme para shteteve anëtare të NATO-s. Si pasojë e kësaj, rëndësia e Forcave të Armatosura të Kosovës do të rritej dhe kjo do të çonte deri tek marrja e përgjegjësisë nga KFOR-i për të garantuar një ambient të qetë dhe të sigurt në vend.
- NATO-ja duhet të zhvillojë, trajtojë dhe ndihmojë në ndërtimin e kapaciteteve mbrojtëse të Forcave të Armatosura të Kosovës sipas programit të NATO-s për ndërveprim. Për më shumë, NATO-ja duhet të ndihmojë në zhvillimin profesional të Forcave të Armatosura të Kosovës dhe të ndihmojë Ministrinë e Mbrojtjes për ushtrimin e kontrollit civil dhe demokratik mbi Forcat e Armatosura të Kosovës.
- Vendet mike të Kosovës në NATO, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Francën, Italinë, Turqinë dhe vende të tjera duhet të ndihmojnë në zhvillimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura të Kosovës.

## LISTA E ANEKSEVE

Tabela 1 – Korniza institucionale e Kosovës kundrejt integritimit në NATO

Zyra e Kryeministrit të Kosovës (ZKMK)	
<i>Këshilli i Sigurisë së Kosovës (KSK)</i>	<p>KSK-ja nuk është e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në marrëdhëniet e Kosovës me NATO-n dhe nuk ka ndonjë përgjegjësi të veçantë në këtë fushë. Roli i saj është kryesisht këshillëdhënës: rishikon politikën e jashtme të sigurisë së Kosovës, rishikon draftet e të gjitha traktateve dhe marrëveshjeve që kanë të bëjnë me sigurinë dhe krijimin e marrëdhënieve ndërmjet agjencive shtetërore të sigurisë dhe agjencive ose organizatave homologe të jashtme ndërkombëtare (Qeveria e Kosovës, 2014, f. 24).</p> <p>Megjithatë, KSK-ja duhet të angazhohet drejtpërdrejt në procesin e anëtarësimit të Kosovës në NATO. RSSS-ja nuk ka parashikuar ndonjë përgjegjësi për KSK-në në këtë drejtim, por roli i saj duhet të rishikohet nga Qeveria e Kosovës.</p>
<i>Grupi Punues për NATO-n (GPN)</i>	<p>GPN-ja do të duhej të themelohet menjëherë pas themelimit të FAK-ut (Çeku, 2014). Qëllimi kryesor i saj do të jetë zhvillimi i rekomandimeve, ideve dhe veprimeve që Qeveria e Kosovës mund të ndërmarrë për të përmirësuar marrëdhëniet e saj me NATO-n, si dhe të vendosë Kosovën drejt pjesëmarrjes në programin e PpP-së, me synim përfundimtar anëtarësimin në NATO (Qeveria e Kosovës, 2014, f. 61).</p> <p>Pavarësisht kësaj, nuk është aspak reale që GPN-ja të themelohet si organ institucional brenda ZKMK-së. Në vend të kësaj, RSSS-ja duhet të rishikohet dhe GPN-ja të funksionojë si një grup punues brenda KSK-së. Përveç kësaj, duhet të rishikohet edhe çështja se kush duhet të udhëheqë GPN-në, meqë aktualisht është e paraparë që ajo të udhëhiqet nga ministri i Mbrojtjes, ndërsa në anën tjetër, përfaqësimi dhe anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare, në këtë rast në NATO, është përgjegjësi e MPJ-së. Kjo e fundit ka rol udhëheqës në këtë çështje, kurse Ministria e MM-ja ka kryesisht rol operativ në marrëdhëniet me NATO-n. Rrjedhimisht, Qeveria e Kosovës duhet të rishikojë strukturën organizative të GPN-së.</p>
<i>Këshilltari për Siguri Kombëtare i kryeministrit</i>	<p>Këshilltari për Siguri Kombëtare është përgjegjës për këshillimin e kryeministrit për politikën e sigurisë lidhur me çështje të brendshme dhe të jashtme. Meqë deri në vitin 2014 marrëdhëniet me NATO-n nuk kanë qenë prioritet më i rëndësishëm për Qeverinë e Kosovës në veçanti dhe për institucionet tjera në përgjithësi, roli i këshilltarit për Siguri Kombëtare duhet të forcohet më shumë lidhur me dhënien e rekomandimeve për bashkëpunimin e mundshëm Kosovë-NATO.</p>
Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ)	
<i>Departamenti për NATO dhe Politika të Sigurisë (DNPS)</i>	<p>DNPS-ja është themeluar në vitin 2013 me qëllim të përgatitjes së dokumenteve të nevojshme të politikave drejt integritimit në NATO. DNPS-ja është përgjegjëse për bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e marrëdhënieve me shtetet anëtare të NATO-s, por edhe të bashkërendojë dhe mbikëqyrë politikën e jashtme sa i përket rritjes së konsensusit dhe përkrahjes së vendeve anëtare për rrugën e Kosovës drejt integritimit në strukturat euro-atlantike (MPJ, 2014).</p> <p>Sidoqoftë, si një organ në kuadër të MPJ-së, DNPS-ja nuk i ka arritur qëllimet e saj në nxjerrjen e dokumenteve lidhur me integrimin në NATO (Ahmeti, 2014). Në të vërtetë, është me rëndësi të vihet në pah se MPJ-ja nuk ka plan se si të vazhdohet tutje me çështjet që prekin bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e Kosovës me NATO-n.</p> <p>DNPS-ja duhet të jetë shumë e kujdesshme për të bashkërenduar çdo hap me GPN-në lidhur me procesin e anëtarësimit në NATO, veçanërisht pas themelimit të GPN-së. Çfarëdo ngatërrese ndërmjet DNPS-së dhe GPN-së duhet të shmanget. Të dyja këto duhet të kenë detyra të veçanta dhe roli i tyre duhet të saktësohet për integrimin në NATO në veçanti, si edhe në hartimin e dokumenteve dhe përgatitjen e vendit për anëtarësim në NATO.</p>

*Kontrolli civil dhe demokratik mbi FSK-në*

MFSK-ja është përgjegjëse për ushtrimin e kontrollit civil mbi FSK-në, duke përfshirë menaxhimin dhe administrimin e saj. Përveç kësaj, ajo përbëhet prej një përzierje të personelit civil dhe ushtarak, ndërsa i jep llogari Kuvendit të Kosovës (MFSK, 2014b). Me qëllim të përmbushjes së misionit të saj, MFSK-ja mbështetet nga NATO-ja. Më saktësisht, NATO-ja vazhdimisht e ka mbështetur me vendosjen e misionit të EKN-së, e cila është një organizatë civile me synim të mbikëqyrjes dhe kontrollit të FSK-së. KFOR-i është i ngarkuar me detyrën për të mbështetur EKN-në (NATO, 2014a). Kjo e fundit është e vendosur në zyrat e MFSK-së.

*Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK)*

FSK-ja ka bërë progres të dukshëm që prej kohës kur ishte themeluar në vitin 2009. Ajo është ndërtuar me ndihmën dhe mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të NATO-s në të gjitha fushat, duke përfshirë rekrutimin, trajnimin dhe në pjesëmarrjen e bashkësive etnike në FSK. Në vitin 2013, FSK-ja i ka arritur Kapacitetet e Plota Operacionale (KPO) që ishin shpallur nga KVA-ja e NATO-s më 9 korrik 2013 (NATO, 2013a). Sipas zyrtarëve të lartë të FSK-së, kjo e fundit ka përmbushur 132 kushte të NATO-s për arritjen e KPO-së (Kastrati, 2014). Sidoqoftë, edhe pas arritjes së KPO-së, roli i FSK-së ka mbetur i njëjtë, kryesisht në udhëheqjen e operacioneve të mbrojtjes civile dhe në ofrimin e ndihmës për autoritetet civile si reagim ndaj fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera. Në këtë drejtim, FSK-ja është përfshirë në kryerjen e funksioneve që nuk janë të zbatueshme për policinë në fushën e sigurisë jo-ushtarake, ndërsa merret edhe me operacionet e kërkimit dhe shpëtimit, largimin e mjeteve eksplozive, kontrollin dhe pastrimin e materialeve të rrezikshme, zjarr-fikjen dhe detyra të tjera të ndihmës humanitare (NATO, 2013b).

Pas arritjes së KPO-së nga FSK-ja, NATO-ja ka vazhduar të ofrojë këshilla dhe përkrahje për zhvillimin e FSK-së duke e themeluar misionin e ENKN-së në Prishtinë, i cili është i ndarë nga misioni i KFOR-it. Ky mision përbëhet prej afërsisht 30 zyrtarëve të personelit ushtarak dhe civil për të ndihmuar në zhvillimin profesional të FSK-së. ENKN-ja synon të përkrahë FSK-në në nivel të brigadës dhe përtej, me theks të veçantë në trajnimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të FSK-së (NATO, 2013b).

Për herë të parë, në vitin 2014, disa prej zyrtarëve të FSK-së e kanë kryer një trajnim ushtarak në shkollat e NATO-s në Gjermani dhe Poloni për programet e edukimit të menaxhimin dhe planifikimin e burimeve. Si rrjedhojë e marrëveshjeve dypalëshe në mes të MFSK-së dhe MM-ve të shteteve anëtare dhe jo-anëtare të NATO-s, pjesëtarë të FSK-së janë dërguar jashtë vendit për edukim dhe trajnime dypalësh në SHBA, Gjermani, Mbretërinë e Bashkuar, Suedi, Shqipëri dhe vende të tjera (MFSK, 2014a, fq. 22-23).

Në vitin 2013 dhe 2014 MFSK-ja dhe MPJ-ja e Kosovës kanë emëruar gjashtë atashe ushtarakë në këto ambasada të Kosovës: Uashington (SHBA), Bruksel (Belgjikë), Berlin (Gjermani), Ankara (Turqi), Tiranë (Shqipëri) dhe Stokholm (Suedi) (MFSK, 2014a, f. 22). Prej këtyre gjashtë vendeve ku janë emëruar atashetë ushtarakë, pesë prej tyre, me përjashtim të Suedisë, janë vende anëtare të NATO-s. Megjithatë, Qeveria e Kosovës duhet të rrisë numrin e atasheve ushtarakë në vendet tjera mike të Kosovës në NATO.



## BIBLIOGRAFIA

- AAB. (17 janar 2015). *Athanassiadou: Greqia nuk e përjashton mundësinë që ta njohë Kosovën*. Gjetur më 18 janar 2015, në: [http://aab-edu.net/news/20/24/Athanassiadou-Greqia-nuk-e-perjashton-mundesine-qe-ta-njohe-Kosoven/d.single\\_image](http://aab-edu.net/news/20/24/Athanassiadou-Greqia-nuk-e-perjashton-mundesine-qe-ta-njohe-Kosoven/d.single_image)
- Armakolas, I., & Karabairis, A. (2012). Greece - Kosovo - A complex relationship. In *Kosovo Calling* (fq. 93-119). Kosovo Foundation for Open Society and British Council. Gjetur më 2 shkurt 2015, në: <http://kfos.org/wp-content/uploads/2012/04/Kosovo-Calling-ENG.pdf>
- B92. (27 dhjetor 2007). *Serbian parliament's Kosovo resolution*. Gjetur më 13 prill 2015, në: [http://www.b92.net/eng/insight/strategies.php?yyyy=2007&mm=12&nav\\_id=46517](http://www.b92.net/eng/insight/strategies.php?yyyy=2007&mm=12&nav_id=46517)
- BBC. (23 mars 2009). *Spain to withdraw Kosovo troops*. Gjetur më 23 dhjetor 2014, në: <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/7958954.stm>
- BBC. (11 nëntor 2014). *Kosovo profile*. Gjetur më 22 dhjetor 2014, në: <http://www.bbc.com/news/world-europe-18331273>
- Burnett, V. (20 mars 2009). *Spain Plans to Withdraw Its Kosovo Peacekeepers*. Gjetur më 23 dhjetor 2014, në: <http://query.nytimes.com/gst/fullpage.html?res=9F06EFD6173FF933A15750C0A96F9C8B63>
- Centre for Democracy and Human Rights. (7 tetor 2014). *Citizens' attitudes on NATO integrations - September 2014*. Gjetur më 22 dhjetor 2014, në: [http://www.cedem.me/index.php?option=com\\_jdownloads&Itemid=38&view=viewdownload&catid=42&cid=567&lang=en](http://www.cedem.me/index.php?option=com_jdownloads&Itemid=38&view=viewdownload&catid=42&cid=567&lang=en)
- Emini, D. (2014). *Kosovo's Membership and Representation in Regional Security Initiatives*. Prishtina: Kosovar Center for Security Studies. Gjetur më 6 janar 2015, në: [http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo%E2%80%99s\\_Membership\\_and\\_Representation\\_in\\_Regional\\_Security\\_Initiatives\\_668693.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo%E2%80%99s_Membership_and_Representation_in_Regional_Security_Initiatives_668693.pdf)
- Engel, E. L. (10 shkurt 2014). *Engel signs bipartisan letter to Kerry urging NATO enlargement*. Gjetur më 23 dhjetor 2014, në: <http://engel.house.gov/index.cfm?sectionid=24&itemid=3669>
- Etchemendy, J. D. (2010). *The developing role of NATO and KFOR's contribution to peacebuilding in Kosovo*. Berlin: CSSProject for Integrative Mediation. Gjetur më 1 dhjetori 2014, në: [http://www.cssp-mediation.org/media/uploads/kfor\\_research\\_paper.pdf](http://www.cssp-mediation.org/media/uploads/kfor_research_paper.pdf)
- European Commission. (21 janar 2014). *Serbia - Membership status*. Gjetur më 13 prill 2015, në: [http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/serbia/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/serbia/index_en.htm)
- Fanés, J. V. (2012). Spain's Position on Kosovo. In *Kosovo Calling* (fq. 9-30). Kosovo Foundation for Open Society and British Council. Gjetur më 2 shkurt 2015, në: <http://kfos.org/wp-content/uploads/2012/04/Kosovo-Calling-ENG.pdf>
- Foreign Policy Initiative BH. (2012). *BiH Public Opinion on the EU Integration Processes 2009-2012*. Foreign Policy Initiative BH. Gjetur më 30 janar 2015, në: [http://www.vpi.ba/upload/documents/eng/BiH\\_Public\\_Opinion\\_on\\_the\\_EU\\_integration\\_process\\_2009-2012.pdf](http://www.vpi.ba/upload/documents/eng/BiH_Public_Opinion_on_the_EU_integration_process_2009-2012.pdf)
- Human Rights Watch. (26 korrik 2004). *Failure to Protect: Anti-Minority Violence in Kosovo, March 2004*. Gjetur më 22 dhjetor 2014, në: <http://www.hrw.org/sites/default/files/reports/kosovo0704.pdf>
- Hurn, M. (23 korrik 2008). *Slovakia: Refusal to Recognize Independent Kosovo*. Gjetur më 13 janar 2015, në: <http://globalvoicesonline.org/2008/07/23/slovakia-refusal-to-recognize-independent-kosovo/#>



- International Court of Justice. (2010). *Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo, Advisory Opinion*. International Court of Justice. Gjetur më 29 nëntor 2014, në: <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15987.pdf>
- International Crisis Group. (2005). *Bridging Kosovo's Mitrovica Divide*. International Crisis Group. Gjetur më 25 nëntor 2014, në: [http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/165\\_bridging\\_kosovo\\_mitrovica\\_divide](http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/165_bridging_kosovo_mitrovica_divide)
- International Republican Institute. (2014). *Survey of Macedonian Public Opinion, August 29 - September 5, 2014*. Skopje: International Republican Institute. Gjetur më 7 janar 2015, në: [http://www.iri.org/sites/default/files/2014%20September%2026%20Survey%20of%20Macedonian%20Public%20Opinion,%20August%2029-September%205,%202014-English\\_0.pdf](http://www.iri.org/sites/default/files/2014%20September%2026%20Survey%20of%20Macedonian%20Public%20Opinion,%20August%2029-September%205,%202014-English_0.pdf)
- Isufi, A. (6 gusht 2010). *Mbikëqyrja e objekteve të shenjta*. Gjetur më 23 dhjetor 2014, në: <http://www.evropaelire.org/content/article/2120720.html>
- Koha Net. (26 gusht 2014a). *Dialogu i NATO-s me Kosovën është i mundshëm*. Gjetur më 23 dhjetor 2014, në: <http://koha.net/?id=27&l=23095>
- Koha Net. (15 dhjetor 2014b). *BeH "Jo" Kosovës në Kartën e Adriatikut, Serbia braktis takimin [video]*. Gjetur më 23 dhjetor 2014, në: <http://koha.net/?id=27&l=37198>
- Kosovar Center for Security Studies. (2014). *Kosovo Security Barometer - Fourth Edition*. Prishtina: Kosovar Center for Security Studies.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. (9 shkurt 2015). Raportimi i ministrit të FSK-së, Haki Demolli në Komisionin për Punë të Jashtme të Kuvendit të Kosovës. Prishtinë. Gjetur më 12 shkurt 2015, në: [http://kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_\\_2015\\_02\\_09\\_14\\_5762\\_al.pdf](http://kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2015_02_09_14_5762_al.pdf)
- Lungescu, O. (8 prill 2008). *Nato Macedonia veto stokes tension*. Gjetur më 12 janar 2015, në: <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/7329963.stm>
- Maksimovic, M. (20 janar 2014). *Serbia's long path to EU accession*. Gjetur më 13 prill 2015, në: <http://www.dw.de/serbias-long-path-to-eu-accession/a-17374164>
- Marinas, R. (18 shkurt 2008). *Romania will not recognize Kosovo independence*. Gjetur më 13 janar 2014, në: <http://www.reuters.com/article/2008/02/18/us-kosovo-romania-idUSL18447620080218>
- Mårtensson, O. (2013). *Understanding the role of the military element in the international intervention in Kosovo - A study of the Swedish military contribution*. Linköpings Universitet. Gjetur më 2 prill 2015, në: <https://www.iei.liu.se/stat/utbildning-grundniva/uppsatser/september/upps/1.494221/Kandidatuppsats-OskarMrtenssonrevised.pdf>
- Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës. (12 shkurt 2012). *Signing of Status of Forces Agreement between The United States of America and The Republic of Kosovo*. Gjetur më 2 prill 2015, në: <http://www.mfa-ks.net/?page=2,4,1122>
- Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës. (2014). *EU and NATO Department*. Gjetur më 19 dhjetor 2014, në: <http://mfa-ks.net/?page=2,93>
- Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës. (2 shkurt 2015). *Thaçi at the Pentagon, receives support for the transformation of the KSF*. Gjetur më 3 shkurt 2015, në: <http://mfa-ks.net/?page=2,4,2531&offset=8>
- Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës. (Gusht 2013). *Newsletter-August 2013*. Gjetur më 2 prill 2015, në: [http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Newsletter\\_August.pdf](http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Newsletter_August.pdf)

- Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës. (2014a). *Annual Report 2014*. Prishtina: Ministry for the Kosovo Security Force. Gjetur më 3 prill 2015, në: [http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Annual\\_Report\\_of\\_MKSF\\_for\\_2014\\_english2.pdf](http://www.mksf-ks.org/repository/docs/Annual_Report_of_MKSF_for_2014_english2.pdf)
- Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës. (2014b). *Kosovo Security Force: Mission Statement*. Gjetur më 19 dhjetor 2014, në: <http://www.mksf-ks.org/?page=2,666>
- Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës. (23 janar 2015). *Minister Demolli and Commander Kastrati met NATO General Secretary, Stoltenberg*. Gjetur më 23 janar 2015, në: <http://www.mksf-ks.org/?page=2,24,1210>
- NATO. (9 qershor 1999). *Military Technical Agreement between the International Security Force ("KFOR") and the Governments of the Federal Republic of Yugoslavia and the Republic of Serbia*. Gjetur më 24 nëntor 2014, në: <http://www.aco.nato.int/resources/site7423/General/Documents/mta.pdf>
- NATO. (8 mars 2001). *Press Release (2001)035 / Secretary General's Statement on North Atlantic Council Measures for Southern Serbia and the former Yugoslav Republic of Macedonia*. Gjetur më 6 janar 2015, në: <http://www.nato.int/docu/pr/2001/p01-035e.htm>
- NATO. (18 shkurt 2008). *Press Release (2008)025 - Statement by the North Atlantic Council after Kosovo's declaration of independence*. Gjetur më 27 nëntor 2014, në: <http://www.nato.int/docu/pr/2008/p08-025e.html>
- NATO. (29 tetor 2010). *Press Release (2010) 147 - Statement by the NATO Secretary General: Progress in Kosovo allows for adaptation of KFOR presence*. Gjetur më 4 dhjetor 2014, në: [http://www.nato.int/cps/en/natohq/news\\_67610.htm?selectedLocale=en](http://www.nato.int/cps/en/natohq/news_67610.htm?selectedLocale=en)
- NATO. (9 korrik 2013a). *Press Release (2013) 085 - NATO Secretary General statement on Kosovo Security Force reaching Full Operational Capability*. Gjetur më 21 dhjetor 2014, në: [http://www.nato.int/cps/en/natohq/news\\_101882.htm?selectedLocale=en](http://www.nato.int/cps/en/natohq/news_101882.htm?selectedLocale=en)
- NATO. (30 qershor 2013b). *The Kosovo Security Force now self-sustainable*. Gjetur më 21 dhjetor 2014, në: [http://www.nato.int/cps/en/natohq/news\\_101890.htm](http://www.nato.int/cps/en/natohq/news_101890.htm)
- NATO. (11 gusht 2014a). *NATO's role in Kosovo*. Gjetur më 26 nëntor 2014, në: [http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_48818.htm#](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_48818.htm#)
- NATO. (5 shtator 2014b). *Press Release (2014) 120 - Wales Summit Declaration issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Wales*. Gjetur më 27 nëntor 2014, në: [http://www.nato.int/cps/en/natohq/official\\_texts\\_112964.htm?selectedLocale=en](http://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_112964.htm?selectedLocale=en)
- NATO. (2014c). *History*. Gjetur më 22 dhjetor 2014, në: <http://www.aco.nato.int/kfor/about-us/history.aspx>
- NATO. (2014d). *Facts & Figures*. Gjetur më 26 nëntor 2014, në: <http://www.aco.nato.int/kfor/library/facts-figures.aspx>
- NATO. (8 nëntor 2014e). *KFOR Press release - KFOR Commander met with Romanian Prime Minister*. Gjetur më 20 dhjetor 2014, në: <http://www.aco.nato.int/kfor/news-room/press-releases/kfor-commander-met-with-romanian-prime-minister.aspx>
- NATO. (19 nëntor 2014f). *NATO's relations with Montenegro*. Gjetur më 23 dhjetor 2014, në: [http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics\\_49736.htm](http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_49736.htm)
- NATO. (31 mars 2014g). *The Partnership for Peace programme*. Gjetur më 7 dhjetor 2014, në: [http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_50349.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_50349.htm)
- NATO. (12 qershor 2014h). *NATO enlargement*. Gjetur më 20 janar 2015, në: [http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_49212.htm#](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_49212.htm#)

- NATO. (17 qershor 2014i). *NATO's relations with Bosnia and Herzegovina*. Gjetur më 14 janar 2015, në: [http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_49127.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_49127.htm)
- NATO. (22 gusht 2014j). *NATO's relations with the former Yugoslav Republic of Macedonia*. Gjetur më 12 janar 2015, në: [http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_48830.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_48830.htm)
- NATO. (23 janar 2015a). *Joint press point with NATO Secretary General Jens Stoltenberg and Isa Mustafa of Kosovo*. Gjetur më 23 janar 2015, në: [http://www.nato.int/cps/en/natohq/opinions\\_116807.htm?selectedLocale=en](http://www.nato.int/cps/en/natohq/opinions_116807.htm?selectedLocale=en)
- NATO. (1 shkurt 2015b). *KFOR "placemat" (Contributing nations and troop numbers)*. Gjetur më 1 shkurt 2015, në: [http://www.nato.int/nato\\_static\\_fl2014/assets/pdf/pdf\\_2015\\_02/20150127\\_150201-kfor-placemat.pdf](http://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/pdf_2015_02/20150127_150201-kfor-placemat.pdf)
- NATO. (23 janar 2015c). *NATO Secretary General says KFOR is a success story in the Western Balkans*. Gjetur më 24 janar 2015, në: [http://www.nato.int/cps/en/natohq/news\\_116791.htm](http://www.nato.int/cps/en/natohq/news_116791.htm)
- NATO Parliamentary Assembly. (2013). *Relations between the NATO Parliamentary Assembly and NATO*. Gjetur më 14 janar 2015, në: <http://www.nato-pa.int/Default.asp?SHORTCUT=5>
- NATO Parliamentary Assembly. (26 qershor 2014a). *Positive progress in Kosovo underscores Belgrade and Pristina's commitment to EU-led normalisation process, despite challenges*. Gjetur më 14 janar 2015, në: <http://www.nato-pa.int/default.asp?SHORTCUT=3510>
- NATO Parliamentary Assembly. (2014b). *121 GEN 14 E - Rules of Procedure*. Vilnius: NATO Parliamentary Assembly. Gjetur më 14 janar 2015, në: <http://www.nato-pa.int/default.asp?SHORTCUT=2999>
- Peci, E. (18 gusht 2010). *Paqartësi për manastiret serbe*. Gjetur më 12 janar 2015, në: <http://www.evropaelire.org/content/article/2131242.html>
- Qehaja, F., & Vrajolli, M. (2011). *Context Analysis of the Security Sector Reform in Kosovo 1999-2009*. Prishtina: Kosovar Center for Security Studies. Gjetur më 3 dhjetor 2014, në: [http://www.qkss.org/repository/docs/Context\\_Analysis\\_of\\_the\\_Security\\_Sector\\_Reform\\_in\\_Kosovo\\_1999-2009\\_470823.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Context_Analysis_of_the_Security_Sector_Reform_in_Kosovo_1999-2009_470823.pdf)
- Qeveria e Republikës së Kosovës. (2014). *Analizë e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës*. Prishtinë. Gjetur më 19 dhjetor 2014, në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Analiza\\_e\\_Rishikimit\\_Strategjik\\_te\\_Sektorit\\_te\\_Sigurise\\_se\\_RKS\\_06032014.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Analiza_e_Rishikimit_Strategjik_te_Sektorit_te_Sigurise_se_RKS_06032014.pdf)
- RACVIAC. (2014a). *RACVIAC's Mission*. Gjetur më 7 dhjetor 2014, në: <http://www.racviac.org/about/mission.html>
- RACVIAC. (13 tetor 2014b). *32nd Financial and Multinational Advisory Group meetings held in RACVIAC*. Gjetur më 9 prill 2015, në: <http://www.racviac.org/news/news14.html#oct>
- Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (10 qershor 1999) UN Doc S/RES/1244. Gjetur më 20 nëntor 2014, në: [http://www.un.org/en/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=S/RES/1244\(1999\)](http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=S/RES/1244(1999))
- Sadiku, E. (3 mars 2014). *Mezhda që (s') po dihet!* Gjetur më 11 janar 2015, në: <http://old.zeri.info/artikulli/30017/mezhda-qe-s-po-dihet>
- Telegrafi. (28 prill 2012). *Mbesin nën përgjegjësinë e KFOR-it*. Gjetur më 12 janar 2015, në: <http://www.telegrafi.com/lajme/mbesin-nen-pergjegjesine-e-kfor-it-2-22066.html>
- Telegrafi. (14 shtator 2014). *Karaqeva sërish proteston në mbrojtje të vijës kufitare*. Gjetur më 23 dhjetor 2014, në: <http://www.telegrafi.com/lajme/karaqeva-serish-proteston-ne-mbrojtje-te-vijes-kufitare-2-50742.html>

- The Slovak Spectator. (27 tetor 2010a). *Parliament approves withdrawal of Slovak troops from Kosovo*. Gjetur më 23 dhjetor 2014, në: [http://spectator.sme.sk/articles/view/40587/10/parliament\\_approves\\_withdrawal\\_of\\_slovak\\_troops\\_from\\_kosovo.html](http://spectator.sme.sk/articles/view/40587/10/parliament_approves_withdrawal_of_slovak_troops_from_kosovo.html)
- The Slovak Spectator. (28 shtator 2010b). *PM Radičová visits Slovak army contingent at Šajkovac base in Kosovo*. Gjetur më 20 dhjetor 2014, në: <http://spectator.sme.sk/c/20037554/pm-radicova-visits-slovak-army-contingent-at-sajkovac-base-in-kosovo.html>
- U.S. Department of State. (25 gusht 2011). *Adriatic Charter*. Gjetur më 14 janar 2015, në: <http://www.state.gov/p/eur/rls/fs/112766.htm>
- United Nations Development Programme. (2006). *Internal Security Sector Review - Kosovo International Security Sector Review*.
- UNOSEC. (31 janar 2006a). *Statement by The Contact Group on The Future of Kosovo - London*. Gjetur më 22 dhjetor 2014, në: <http://www.unosek.org/docref/fevrier/STATEMENT%20BY%20THE%20CONTACT%20GROUP%20ON%20THE%20FUTURE%20OF%20KOSOVO%20-%20Eng.pdf>
- UNOSEC. (24 korrik 2006b). *Contact Group Statement/High-Level Meeting on the Future Status of Kosovo - Vienna*. Gjetur më 22 dhjetor 2014, në: [http://www.unosek.org/docref/Statement\\_of\\_the\\_Contact\\_Group\\_after\\_first\\_Pristina-Belgrade\\_High-level\\_meeting\\_held\\_in\\_Vienna.pdf](http://www.unosek.org/docref/Statement_of_the_Contact_Group_after_first_Pristina-Belgrade_High-level_meeting_held_in_Vienna.pdf)
- Vrajolli, M., & Kallaba, P. (2012). *Kosovo's path towards the NATO Partnership for Peace (PfP) Programme*. Prishtina: Kosovar Center for Security Studies. Gjetur më 17 nëntor 2014, në: [http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo's\\_Path\\_towards\\_the\\_NATO\\_Partnership\\_for\\_Peace\\_Programme\\_839019.PDF](http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo's_Path_towards_the_NATO_Partnership_for_Peace_Programme_839019.PDF)
- Zyra e Kryeministrit të Kosovës. (23 janar 2015). *Kryeministri Isa Mustafa priti në takim Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg*. Gjetur më 23 janar 2015, në: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,4665>
- Zyra e Kryeministrit të Kosovës. (17 shkurt 2014). *Speech of Prime Minister Hashim Thaci at military parade in honor of Independence Day of Republic of Kosovo*. Gjetur më 31 janar 2015, në: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,9,4039>
- Zyra e Presidentit të Kosovës. (23 janar 2015). *President Jahjaga received the NATO Secretary General, Jens Stoltenberg*. Gjetur më 24 janar 2015, në: <http://www.president-ks.gov.net/?page=2,6,3706>

---

## INTERVISTAT

---

Agim Çeku (24 tetor 2014), ish-ministër për Forcën e Sigurisë së Kosovës (shkurt 2011 – dhjetor 2014).

Augustin Palokaj (24 tetor 2014), korrespondent i gazetës së përditshme “KOHA Ditore” në Bruksel.

Dhurata Hoxha (22 tetor 2014), ish-këshilltare për Siguri Kombëtare e kryeministrit të Kosovës.

Garentina Kraja (22 tetor 2014), këshilltare për Politikë të Jashtme dhe Siguri e presidentes së Kosovës.

Kolonel Ivica Matešić (10 nëntor 2014), atashe ushtarak në Ambasadën e Kroacisë në Prishtinë.

Gjenerallejtënant Kadri Kastrati (24 tetor 2014), ish-komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës (nëntor 2011 – mars 2015).

Xhafer Ahmeti (14 nëntor 2014), drejtor i Departamentit për NATO dhe Politika të Sigurisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës.



Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

061.1(4/9:496.51):355

327(496.51:4/9)

Avdiu, Plator

Destinacioni në NATO: Alternativat për Kosovën drejt  
anëtarësimit në NATO / Plator Avdiu. – Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të  
Sigurisë. – 48 f. ; 21 cm.

Bibliografia : f. 40-45.

**ISBN 978-9951-679-22-0**

[www.qkss.org](http://www.qkss.org)

ISBN 978-9951-679-22-0

